

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7694 E martë 30 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

## Opinion *i* Ditës

**A**ksioni i Kostandin Kaçifas nuk ka qenë i panjohur për autoritetet greke. Madje ata kishin djepi për përkatesinë e tij politike, ekstremizmin ...  
Vijon në faqen 20

Nga DRITAN HILA

E vërteta e thjeshtë e vrasjes së Kostandin Kaçifas



## Dje *në* "Deutsche Welle"

Imazhet e breshkave të detit që lmybyten nga një pipë plastike dhe delfinëve, që vdesin në rrjetat e peshkatarëve kanë dhënë efektin e tyre shokues ...  
Vijon në faqen 21

Nga BARBARA WESEL

BE-ja kundër mbetjeve plastike



Vrasja e minoritarit, sherr në Tiranë  
**Sali Berisha kërkon hetim për "Bularatin", 'shpërthen' Rama: Je materie e biodegraduar**

Ish-kreu i PD: Dënoj reagimet Athinë-Tiranë.  
Rama: Pisllek. Basha: Fole me gjuhë banditi

VALENTINA MADANI

Vrasja nga policia e minoritarit grek, Kostandino Kacifa në fshatin Bularat të Gjirokastrës përplasi dje ish-kryeministrin Sali Berisha dhe pasardhësin e tij Edi Rama, reagimi i ashpër i të cilit nxitoi një tjetër reagim ...  
Në faqen 5

## AKTI EKSTREMIST/ VIKTIMA U PERGATIT, KISHTE 3 KREHERA TE BASHKUAR GREKU QELLOI POLICINE ME AUTOMATIK TE MODIFIKUAR

Përforcohen dyshimet për provokim të organizuar. Dyshimi, ushtaraku grek nuk veproi vetëm. Publikohen fotot kur qëlloi mbi policinë me armë me dylbi



(Në foto) Kostandin Kacifa me një automatik në dorë teksa qëllon në drejtim të automjetit të policisë në qendër të fshatit Bularat  
Në faqet 2-4

### "OFERTA E RAMES PER MUA"

**Sandër Lleshi: Ja çfarë mendoj për Fatmir Xhafajn dhe Saimir Tahirin**

Në faqen 5

### CEREMONIA

**Aeroporti i ri, Erdogan bën bashkë Metën, Thaçin dhe Vuçiqin në Stamboll**

Në faqen 7

### "S'KA VEPER PENALE"

**Trafiku i drogës, prokuroria italiane mbyll çështjen për Saimir Tahirin**

Në faqen 11

### KANCELARJA

**Merkel pas 18 vitesh në krye të CDU: Nuk do të kandidoj për një mandat tjetër**

Në faqen 14

### EMRAT



**60 punonjësit e shëndetësisë që duhet të rristojnë aftësitë profesionale**

Në faqen 9

Shkurtime e filmave në Kinostudio. U hoq nga qarkullimi "Shën Tereza dhe djajtë"

## Pirro Kondi: Të ndalohet "Gruaja më e bukur"

Dossier/ Letra e oficerit Koço Danaj për sekretarin e Enverit, Haxhi Kroj

NGA DASHNOR KALOÇI

**B**rezi i shqiptarëve që kanë qenë në moshë të rritur në fillimin e viteve '70-të e kujtojnë fare mirë se si thyeshin sportelet e biletave dhe dyert e kinemave në mbarë vëndin kur shfaqeshin filma të huaj, si p.sh. ato të regjizorit



të famshëm italian, Damiano Damiani, "Gruaja më e bukur" (La Miglie Piu Bella) të interpretuar nga aktorja Ornella Muti, (asokohe 14 vjeçare) në rolin e Franceska Cimrozës dhe Alesio Orano në rolin e Vito Juvares, apo "Rrëfimet e Komisarit të Policisë" ...  
Në faqen 16-17

## EKSTREMISTI GREK REAGIMET

Zëdhënës i qeverisë greke, Dhimitris Xhanakopoulos: Shqipëria të ulë tonet

# Policia greke: Nuk ka asnjë provokim, Konstandin Kaçifa nuk u vra për flamur "Notë proteste për Bularatin", Athina zyrtare thërret ambasadorën shqiptare

GREQI

Ekzekutimi i 35-vjeçarit grek në fshatin Bularat të Gjirokastrës, Konstandin Kaçifa, i cili terrorizoi banorët me armë dhe sulmoi policinë ka pasuar me reagime të shumta në Greqi dhe Shqipëri. Policia greke ka rrëzuar të gjitha pretendimet që minoritari Kaçifa të jetë vrarë për flamurin apo të jetë provokuar nga pala shqiptare. E përditshmja greke "Kathimerini", por edhe media të tjera të Athinës citojnë burime zyrtare të policisë greke, që thonë se autoritetet e vendit të tyre kanë qenë vazhdimisht në kontakt me palën shqiptare. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Greke, Aristeidis Andrikopoulos, ka kontaktuar me homologun e tij shqiptar dhe është mbajtur vazhdimisht i informuar për situatën që po ndodhte në Bularat të Gjirokastrës. Edhe burime nga Policia e Shtetit konfirmojnë për "Gazeta Shqiptare" se ka pasur komunikim përmes kanaleve zyrtare me homologët grekë. "Kathimerini" shkruan gjithashtu se burime zyrtare nga Policia e Athinës i kanë thënë se nuk ka prova apo dëshmi që Kostandino Kaçifa të jetë vrarë për ngjarjen e flamurit grek. Vetë policia e vendit fqinj e mohon që 35-vjeçari minoritar të jetë provokuar nga policia shqiptare apo faktorë të tjerë. Gjithashtu, policia greke ka kërkuar pjesëmarrjen për zbardhjen e vrasjes së 35-vjeçarit. Të njëjtat burime theksojnë se po kryhen veprimet e duhura në rrugën diplomatike për pjesëmarrjen e palës greke në hetimin e ngjarjes, duke u informuar në kohë si dhe me çdo formë bashkëpunimi të kërkuar nga autoritetet shqiptare. Policia greke informon se Kostandinos Kaçifas mori pjesë në përgatitjen e fshatit për festën, në vendosjen e flamurit,



### HETIMI

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka marrë në dorë hetimin e ngjarjes së Bularatit, ku u vra nga forcat RENEA, Kostandinos Kaçifa. Hetimi është duke u zhvilluar për veprën e vrasjes së oficerit të policisë e mbetur në tentativë. Në vendin e ngjarjes deri tani janë gjetur 44 gëzhoja. Është gjetur edhe arma e viktimit, një kallashnikov i pajisur me një dybl. 35-vjeçari Kaçifa ka qenë i veshur me rroba ushtarake dhe në shtëpi i është gjetur edhe një uniformë tjetër.

## "Çmendet" politikani grek: Të ngrihen të gjithë dhe të zhdukim shqiptarët

GREQI - Vrasja e minoritarit grek dy ditë më parë në Bularat të Gjirokastrës ka shkaktuar tensione mes të dyja vendeve. Një politikan grek përmes një video mesazhi ka bërë thirrje raciste ndaj shqiptarëve, ku kërkon që të nisnin menjëherë bombardimet për Shqipërinë. Presidenti i së Drejtës së Re, Phaselos Kranidiotis, shton se kjo është e vetmja rrugë që pengon dhe detyron Edi Ramën që të mbajë dorën larg grekëve. "Të ngrihen



të gjithë, të mos lëmë gurë pa lëvizur dhe të shfarosim të gjithë vrasësit e heroit Kostandinos Kaçifas, kjo

krejt normalisht", - thuhet në reagimin e policisë greke. Ndërkohë, ambasadorja shqiptare në Athinë, Ardiana Hodari është thirrur pasditen e djeshme në Ministrinë e Jashtme të Greqisë, ku diplomatet do i dorëzohet notë proteste për ngjarjen në fjalë. Sikurse shkruan "Kathimerini", Ministria e Jashtme e Greqisë vazhdon të protestojë

për vdekjen e minoritarit grek në Shqipëri, pavarësisht se policia greke thotë se ka qenë në dijeni që në fillim të operacionit të RENEA-s dhe mohan që 35-vjeçari të jetë vrarë për uljen e flamurit. Ndërkaq, e përditshmja tjetër "I Efimerida" shkruan se policia greke ka shtuar masat e sigurisë në ambasadën shqiptare në Athinë, në Zyrën

është e vetmja mënyrë që Edi Rama të mos guxojë të ngre dorën ndaj grekëve", shprehet politikanin grek. Kjo deklaratë e politikanit nacionalist vjen pas një takimi që ai ka pasur për çështjen e emigrantëve në Greqi. Jo vetëm kaq, por Kranidiotis i ka cilësuar shqiptarët si ashkëpunëtorë të nazizmit. "Vranë, dogjën dhe plaçkitën Epirin Grek. Është e pakonceptueshme që Shqipëria të jetë një nga remitancat që vijnë nga Greqia", ka shkruar ai më tej.

Konsullorë shqiptare në Selanik, si dhe në biznese e dyqane që i përkasin komunitetit shqiptar në Greqi, për të shmangur çdo episod të dhunshëm nga ekstremistët. Në të njëjtën kohë ekziston frika edhe për të burgosurit shqiptarë në burgjet e paraburgimit e Greqisë.

Gjithashtu, në lidhje me ngjarjen e ndodhur të dielën



Forcat RENEA në fshatin Bularat

## Vrasja e minoritarit, reagon ashpër OMONIA: Ekzekutim i ftohtë

Për ngjarjen në Bularat ka reaguar edhe organizata politike e minoritetit OMONIA. Përmes një deklaratë për shtyp, ajo ka cilësuar vrasjen e Kostandinos Kaçifas një 'ekzekutim të ftohtë'. Teksa ka dënuar ngjarjen e rëndë, Omonia akuzon policinë shqiptare se kjo e fundit nuk i është përmbytur rregullores, ndërkohë që nuk ka lënë pa shigjetuar edhe qeverinë shqiptare për prodhimin e "klimës së dhunës", sipas tyre kundër minoritetit. "Dëshpërim për ekzekutimin e Kostandinos Kaçifas. Shqetësim për minoritetin grek të Shqipërisë pas ngjarjes së rëndë dhe propagandës së thellë antihelene. Trishtim dhe indignatë e thellë, janë ndjenjat tona pas përfundimit të operacionit policor, ku mbeti i vdekur Kostandinos Kaçifas. Sipas vlerësimeve të para, policia injoroi rregulloren e izolimit të një personi të vetëm duke e ekzekutuar. Është e rëndësishme të theksojmë faktin se këto ndodhën, ndërsa në Bularat zhvillohej ceremoni përkujtimore me përfaqësi zyrtare diplomatike dhe qeveritare nga të dy vendet. Mesa duket, nuk bëhet fjalë vetëm për shkeljen e të drejtës bazë të njeriut, por edhe të jetës. Por, është një klimë e tërë psikologjike e dhunës në kurriz të minoritetit. Urojmë forcat policore që zbriten nga Tirana të mos jenë ndikuar nga klima antihelene, që propagandohej nga minutat e para të debatit të Kostandinos Kaçifas me policinë lokale. Apo nga thirrjet e menjëhershme të partive dhe organizatave antihelene, apo dhe nga përpjekja e madhe e Tiranës të ndryshojë axhendën. Mesazhi që i dhanë minoritetit dhe të ftuarve në ditën e sotme është fatkeqësisht i hidhur. Ne, OMONIA, vazhdojmë të denoncojmë padrejtësinë nga tensioni frymëmarrës i medias që fatkeqësisht hedh i benzinë zjarrit", - thuhet në deklaratën e OMONIA-s.

në Bularat të Gjirokastrës ka reaguar edhe kryetari i shoqatës së Homogjeneve për Greqinë, Haralambos Karathanos, i cili ka folur në "Skain" grek. Sipas tij, "ish një ekzekutim i ftohtë". "Imagjioni të vriste kësh-tu policia greke, nëse do kish-të mundësinë të arrestonte një shqiptar", tha Karathanos. Ministri i shtetit dhe zëdhënës i qeverisë, Dhimi-

tris Xhanakopoulos tha se, "autoritetet greke janë në komunikim të vazhdueshëm me autoritetet shqiptare për sqarimin e rrethanave të ngjarjes. Të mos nxitojmë të nxjerrim rezultate", tha ai. Ndërkaq, ka theksuar se qeveria shqiptare duhet të ulë tonet të mos e trajtojë çështjen me agresivitet, për të mos ushqyer refleksat sociale.

REDAKSIONI: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rretheve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXH.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokhina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotaktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123, Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



Banorët e fshatit Bularat: Konstandini ishte djalë i mirë, nuk duhej të ishte qëlluar

# Vrasja e ekstremistit grek, nëna: Nuk e dua më jetën pa tim bir, e hëngrën qentë shqiptarë

## Familja hap dyert e mortit. Refuzuan tërheqjen e trupit nga morgu, kërkojnë ekspertizë nga Greqia

**GJIROKASTËR**

Pse ma vranë tim bir, përse trimin tim! E hëngrën qentë shqiptarë, nuk e dua minoretin grek. Tani nuk kam ç'e dua jetën pa djalin tim, pa shpirtin tim. Nuk e duroj dot këtë dhimbje". Kështu është shprehur mes lotëve nëna e Kostandin Kaçifas, 1 cili mbeti i vrarë të dielën në Bularat të Gjirokastrës pas shkëmbimit të zjarrit me policinë. Në një prononcim për mediat greke, nëna e 35-vjeçarit, përmes dhimbjes së madhe për humbjen e të birit, ka thënë se shqiptarët nuk i domin pakicat. "Tani unë nuk e dua jetën pa fëmijën tim, pa shpirtin tim", ka pohuar ajo. Ndërkohë, mësohet se i riu jetonte prej vitesh në Greqi, por kthehej shpesh në fshat, mbi kodrën e të cilit kishte ngritur një flamur, krenar për përkatësinë e tij greke. Mësohet se edhe dy motrat e viktimës, që jetojnë prej vitesh në Athinë kanë shkuar në fshat gjatë natës për t'i qëndruar pranë nënës së tyre. Një ditë pas vrasjes së ushtarit ekstremist grek në Bularat të Gjirokastrës, situata në këtë fshat, në pamje të parë është e qetë, por banorët kundërshtojnë vepërimin e policisë shqiptare. Familja e 35-vjeçarit Konstandin Kaçifas; mamaja dhe dy motrat e tij, bashkë me të afërmit kanë hapur dyert e mortit. Fillimisht ata kanë refuzuar të tërheqin trupin e pajetë të 35-vjeçarit nga morgu, pasi kundërshtojnë ekspertizën mjeko-ligjore të spitalit të Gjirokastrës. Ata kërkojnë ekspertizë të pavarur me pjesëmarrjen edhe të specialistëve grekë. Por, burime policore bënë me dije se më pas familja Kaçifas ka arritur dakordësinë për të tërhequr trupin nga morgu, ndërsa ditën e sotme do të bëhet varrimi. Në shtëpinë me portë blu dhe me oborrin me shumë lule, shkallët e ndërtaura me pllaka guri, ka pllakosur zia, ndërkohë që gra të veshura me të zeza shkojnë për ngushëllim. Në familjen e Kaçifas ka shkuar edhe konsulli grek, Vasileos Tolos, pasi ata janë pjesë e minoritetit grek. Pas ngjarjes së



Nëna e 35-vjeçarit të vrarë



Kostandin Kaçifa

### Vrasja në Bularat, të afërmit e Kaçifas: Djali bëri një budallallëk

**GJIROKASTËR** - Pas vrasjes së Kostandin Kaçifas, reagimet që vijnë në lidhje me ngjarjen janë të ndryshme. Banorët të fshatit Bularat dhe deklaruan se 35-vjeçari ishte njëri i mirë dhe nuk duhej të vritej. Ndërkaq, disa të afërmit të tij deklaruaran për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" se ajo që Kostandinos bëri, ishte një budallallëk dhe se një ngjarje e tillë nuk duhet të politizohet. "Mediat shqiptare e greke japin informacione të pavërteta. Djali bëri një budallallëk dhe një ngjarje e tillë nuk ka pse të politizohet. Po përpiqemi të qetësojmë ujërat si në Greqi, edhe në Shqipëri. Ka të çmendur nga të dyja palët, kështu që të mos u japim shkas ekstremistëve. Jemi fqinj dhe gjërat nuk duhet të keqinterpretohen", janë shprehur ata.



### Çfarë shkroi minoritari në qendër të fshatit para vrasjes

**GJIROKASTËR** - Një ditë para festës kombëtare të Greqisë në Bularat, si pjesë e zbukurimeve të kësaj feste, 35-vjeçari ka vizituar në qendër të këtij fshati flamurin grek dhe ka shkruar në greqisht emrin e këtij fshati. Të dielën ai mbeti i vrarë nga forcat speciale. Gjithçka nisi rreth orës 10:00, kur Kaçifas nisi të qëllonte me armë zjarri në ajër, duke shkaktuar panik te banorët e zonës, të cilët ishin mbledhur në qendër për të festuar festën e Greqisë, e cila si çdo vit po organizohet edhe në këtë fshat. Menjëherë në drejtim të vendit nga vinin të shtënat shkuan shërbimet e policisë, të cilat ishin të dislokuara në qendër të fshatit, pasi do zhvillohej aktivitet me rastin e festës së Greqisë. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se shtetasit Kostandinos Kaçifa pasi ka parë shërbimet e policisë që po afroreshin në drejtim të tij, ka hapur zjarr me breshëri ndaj punonjësve të policisë, duke rrezikuar jetën e tyre.



rëndë, ku pas shkëmbimit të zjarrit me policinë mbeti i vrarë 35-vjeçari Kostandinos Kaçifas, banorët e zonës shprehen të indinjuar. Të gjithë banorët e këtij fshati, ku dy ditë më parë do të mbaheshin festimet për festën kombëtare të Greqisë, kanë reaguar për ngjarjen në fjalë, ndërsa shprehen se i riu nuk duhej të vritej nga policia. "Konstandini ishte djalë i mirë. Nuk duhej të vritej, ishte njëri dhe jo kafshë", thanë banorët e fshatit Bularat. Banorët kanë ngritur piramida përkujtimore në vendin ku mbeti i vdekur minoritari grek.

**VRASJA**

Zbardhen detaje të reja në lidhje me vrasjen e ekstremistit grek. "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" kanë mësuar lëvizjet e të minoritarit. Mësohet se pak pasi ai hapu zjarr i pari ndaj policisë, pasi qëllonte me armë në ajër, Kaçifas mori rrugën drejt banesës së tij në fshat. Pasi u vesh me shpejtësi me një uniformë ushtarake, që shërbente mirë edhe për t'u kamufluar ndaj policisë, mori një cantë mjete luftarake, 3 karikatorë me fishekë dhe më pas tentoi të humbiste gjurmët. Pas disa orësh kërkimesh, ku në aksion ish-

te e pranishme FNSH-Ja si dhe RENEJA, këta të fundit bënë të mundur lokalizimin e autorit. Pavarësisht thirrjes së policisë për t'u dorëzuar, 35-vjeçari nuk iu bind urdhrat, ndërsa vijonte të qëllonte me armë zjarri, ndërkohë që njëri prej plumbave të policisë e preku në gjoks, duke i shkaktuar atij vdekjen. Nga ana tjetër, forcat RENEJA kanë deklaruar se ka qenë e pamundur që ai të neutralizohet, pasi 35-vjeçari guante pa pushim me armë. Burime nga prokuroria do të hetojnë nëse kishte mundësi që autori të neutralizohet nga poli-

cia, ndërkohë që ngjarja ka përfshirë edhe politikën e të dyjave vendeve, Shqipërisë dhe Greqisë. Gjithashtu, mësohet se 35-vjeçari para pak kohësh ishte divorcuar, martesë nga e cila kishte një vajzë 10 vjeçe. Ndërkohë, banorët e zonës pohan se i riu kishte shfaqur shenja depresioni pas divorcit, por nuk ishte person me probleme të shëndetit mendor. Sipas tyre, ai vinte shpesh në fshat, pasi aty jetonte nëna e tij. Mendohet se ai kishte probleme të depresionit, por jo të shëndetit mendor, për shkak të problemeve familjare. Kjo mbetet për t'u verifikuar.



**Zbulohet e kaluara kriminale e Kaçifas, u arrestua në 2009-ën për trafik droge**

**TRIANË** - Të tjera detaje janë zbuluar pas vrasjes së minoritarit grek, Kostandin Kaçifa nga RENEJA në Bularat të Gjirokastrës, pas dyluftimit me policinë shqiptare. Mediat greke shkruajnë se 35-vjeçari i lindur në Bularat dhe banues në Athinë rezultoi person me precedentë penalë në Greqi. Mësohet se ai është arrestuar në vitin 2009 nga policia greke në Halandri, në periferi të Athinës, pasi është kapur me rreth 1 kg hashash. Prokuroria në Athinë e ka akuzuar 35-vjeçarin në vitin 2009 për akuzën e trafikut të drogës si dhe si pjesëtar të një organizate kriminale. Pas vrasjes së ushtarit ekstremist grek, Konstandinos Kaçifa, reagime të shumta kanë pasuar në mediat e vendit fqinj, por edhe mediet botërore. "Washington Post", në pasqyrimin e kësaj ngjarjeje shkruan se Kaçifa u vra në dyluftim me policinë në Shqipëri. Mediet botërore shkruajnë se Kaçifa u vra pas një dyluftimi me policinë shqiptare.

## NGJARJA REAGIMET

"Në Kakavijë u ndaluan dy anëtarë të Vorio Epirit, u liruan me ndërhyrjen e konsullit grek"

# Vrasja, Idrizi: I kundërshtuam, por varrezat greke vend konfliktesh

"Donim të parandalonim ngjarje të tilla"

Valentina Madani

Për PDIU-n, ajo që ndodhi dy ditë më parë në Bularat të Gjirokastrës, ku një ekstremist grek mbeti i vrarë është alarm për institucionet e sigurisë kombëtare. Kreu i PDIU, Shpëtim Idrizi reagoi sërisht dhe për ngjarjen e ndodhur në Bularat. Në një dalje për mediat, Idrizi u shpreh se për shume arsye, por edhe që të parandaloheshin ngjarje të tilla, PDIU e ka kundërshtuar ngritjen e varrezave të ushtarëve grekë, që erdhën si pushtues në territorin e Shqipërisë. Kreu i PDIU-së bëri të qartë se kundërshtimi i ngritjes së varrezave greke është bërë pikërisht për të parandaluar ngjarje të tilla. Idrizi përmendi se në 25 tetor policia ndaloj në Kakavijë dy anëtarë të bandës së Vorio Epirit dhe më pas u lanë të lirë me ndërhyrjen e konsullit grek. "Për shumë arsye, por edhe që të parandaloheshin ngjarje të tilla, ne e kemi kundërshtuar ngritjen e varrezave të ushtarëve grekë, që erdhën si pushtues në territorin e Shqipërisë. Ngritja e këtyre varrezave dhe dhënia e Statusit të Varrezave Historike dhe shndërrimi i tyre në vend pelegrinazhi çdo vit kanë gjallëruar qarqet ekstremiste greke të Vorio Epirit, si në rastin e djeshëm, por edhe të patriotëve shqiptarë, të cilëve u hiqet e drejta e protestës dhe ndalohen nga policia", theksoi z.Idrizi. Sipas tij, festa e Greqisë mund të festohet në Greqi, e jo me ekstremistë të importuar në varre imagjinare ushtarësh pushtues grekë dhe që lëvizin të lirë, duke rrezikuar integritetin tonë. Në bindjen e kreu të PDIU-së, ky është rasti për të ngritur alarmin për institucionet e sigurisë kombëtare, SHISH, prokurorinë etj., sepse "si është e mundur që persona të tillë, që në profilet e tyre e tregojnë hapas që janë ushtarë të Vorio Epirit, nuk ndalohen?! Unë sot dua të bëj dy pyetje për Ministrinë e Brendshme dhe SHISH. A janë ndaluar më 25 tetor nga Policia e Shtetit në pikën e Kakavijës anëtarë të bandës



Kreu i PDIU-së, Shpëtim Idrizi

### SHPËTIM IDRIZI

"A janë ndaluar më datë 25 tetor nga Policia e Shtetit në pikën e Kakavijës anëtarë të bandës së Vorio Epirit, shtetasit grekë Mondis Kokalias dhe Theodoros Asvestopoulos për 4 orë? A janë liruar më pas këta shtetas me ndërhyrjen e konsullit grek të Gjirokastrës?", u shpreh kreu i PDIU.

## Kreu i PBDNJ: Policia të mbajë përgjegjësi

Vrasja e minoritarit, Dule: Shumë pikëpyetje, ekspertizë e përbashkët me Greqinë

Për kryetarin e PBDNJ, Vangjel Dule, ka shumë pikëpyetje në lidhje me vrasjen e Kostandinos Kacifës të dielën në Bularat të Gjirokastrës. Në një deklaratë për gazetarët, pas vizitës në familjen e të ndjerit, Dule u shpreh se hetimi duhet të jetë transparent. "Për këtë - tha ai - duhet një ekspertizë e përbashkët nga Shqipëria dhe Greqia". "Dëshiroj që të tërheqim thirrjen tonë për gjakftohtësi, por të demonstrojmë vendosmëri se kjo çështje duhet zbardhur në të gjitha detajet e saj, me të gjithë transparencën e mundshme. Ka shumë pikëpyetje që e bëjnë më delikate. Si nisi konflikti dhe nga u provokua? Mbetet ende pa përgjigje. Cilat ishin rrethanat dhe nga kush u mor




vendimi për të dhënë një zgjidhje fatale, ndërkohë që ekzistonin edhe alternativa të tjera që do të garantonin jetën. Prioritet i parë dhe i fundit në çdo operacion policie, me përjashtim të vendit të Kim Jong Un-it është shpëtimi i jetëve të forcave të rendit dhe së dyti, i atij ndaj të cilit operojnë. Gjë që mesa duket është shkelur në rastin konkret", deklaroi z.Dule. Sipas tij, policia vuri vetë në pikëpyetje operacionin e djeshëm, ndërsa për ta bërë

edhe më të besueshme zbardhjen e së vërtetës do të duhet edhe një ekspertizë europiane. "Policia e ka vënë vetë në pikëpyetje operacionin e saj të djeshëm. Duhet që të jemi të ndërgjegjshëm për pikëpyetjet që si në këtë rast, por edhe në rastet të tjera, çdo qytetar ka për policinë e vendit tonë. Në këto kushte është e domosdoshme që duke qenë se kemi edhe rastin e nënshtrësive për të ndjerin, që ekspertiza mjeko-ligjore të jetë e përbashkët edhe me një ekspert nga shteti grek, ku në të njëjtën kohë ishte shtetas. Por në të njëjtën kohë kërkohet që këtë proces të i jepet besueshmëria, të ketë garancinë edhe mendimin dhe vlerësimin e ekspertëve europianë", tha kreu i PBDNJ-së.

së Vorio Epirit, shtetasit grekë Mondis Kokalias dhe Theodoros Asvestopoulos përreth 4 orë? A janë ndaluar më pas këta shtetas me ndërhyrjen e konsullit grek të Gjirokastrës", u shpreh Shpëtim Idrizi. PDIU i bën thirrje Ministrisë së Jashtëm të kërkojë urgjentisht nga autoritetet greke shpjegime

urgjent për ngjarjen e djeshme. Veprimtarinë e organizatave terroriste të Vorio Epirit në Greqi, siç e pamë edhe të dielën në aktivitetin e dhunshëm përpara ambasadës shqiptare në Athinë, ku protestohet me flamur të Vorio Epirit. "Ministria e Jonë e Jashtëm duhet të kërkojë shpjegime urgjent nga shteti grek dhe për financimet sekrete të Ministrisë së Jashtëm, standard që nuk ekziston në diplomacitë perëndimore. PDIU do të kërkojë zyrtarisht që prokuroria të hapë hetimet për fondet sekrete greke, për të cilën ne po bëjmë gati denoncimin tonë", theksoi kreu i PDIU-së, Shpëtim Idrizi.

ti grek dhe për financimet sekrete të Ministrisë së Jashtëm, standard që nuk ekziston në diplomacitë perëndimore. PDIU do të kërkojë zyrtarisht që prokuroria të hapë hetimet për fondet sekrete greke, për të cilën ne po bëjmë gati denoncimin tonë", theksoi kreu i PDIU-së, Shpëtim Idrizi.



Kryeministri Edi Rama dhe homologu Aleksis Cipras

### HETIMI

"Ministria e Jonë e Jashtëm duhet të kërkojë shpjegime urgjent nga shteti grek dhe për financimet sekrete të Ministrisë së Jashtëm, standard që nuk ekziston në diplomacitë perëndimore. PDIU do të kërkojë zyrtarisht që prokuroria të hapë hetimet për fondet sekrete greke, për të cilën ne po bëjmë gati denoncimin tonë", theksoi kreu i PDIU-së, Shpëtim Idrizi.



## Koço Kokëdhima: Krim i pabesë e tradhti kombëtare e Ramës

Kreu i partisë "Zgjidhja", Koço Kokëdhima, reagoi dhe për paktin Shqipëri-Greqi për festën e 28 tetorit. Sipas Kokëdhimës, marrëveshja për festimet e qytetarëve grekë në ditën e "JO"-së, është firmosur gjatë vizitës së Kotzias në Korçë në vitin 2017.

"Nuk ka fjalë për të përshkruar këtë akt tradhtie nga qeveritarët gjakprishur, që flasin dhe firmosin në emër të shqiptarëve. Të pranosh se 28 tetori është ditë feste zyrtare edhe për Shqipërinë do të thotë të pranosh se ushtria greke ishte çlirimtarja e jugut në vitin 1940. E vërteta historike është tjetër. Me pretekstin e çlirimit të Greqisë nga Italia fashiste, ushtria e saj justifikoi pushtimin e jugut të Shqipërisë, për të realizuar ëndrrën e vjetër shoviniste të 'Vorio Epirit', bëri, për të disatën herë, masakrat më të përgjakshme ndaj popullsisë civile dhe të pambrojtur shqiptare dhe mbushi me grekë dhe nëpunës filogrekë administratat vendore në bashkitë dhe prefekturat e jugut shqiptar", shprehet z.Kokëdhima.



### REAGIMI

"Nuk ka fjalë për të përshkruar këtë akt tradhtie nga qeveritarët gjakprishur, që flasin dhe firmosin në emër të shqiptarëve. Të pranosh se 28 tetori është ditë feste zyrtare edhe për Shqipërinë do të thotë të pranosh se ushtria greke ishte çlirimtarja e jugut në vitin 1940".





Ish-kryeministri: Ndal histerisë primitive antishqiptare në Athinë dhe asaj antigreke në Tiranë

# "Bularati", Berisha: Të mos përdoret politikisht. Rama: Pisllek

Basha: Ish-kryeministri u sulmua me gjuhë banditi

Valentina Madani

Vrasja nga policia e minoritarit grek, Ko standino Kacifa në fshatin Bularat të Gjirokastrës përplasi dje ish-kryeministrin Sali Berisha dhe pasardhësin e tij Edi Rama, reagimi i ashpër i të cilit nxiti një tjetër reagim të kreut të opozitës, Lulzim Basha. Ish-kryeministri Sali Berisha dje bëri thirrje që të marrë fund histeria antishqiptare në Athinë, ndërsa kërkoi që Athina e Tirana të mos e përdorin ngjarjen e Bularatit për qëllime politike. Berisha dënon aktin që vuri në rrezik forcat e rendit dhe i shpreh ngushëllime familjes së 35-vjeçarit. Ai bëri thirrje për ndalimin e histerisë primitive antishqiptare në Athinë dhe asaj greke në Tiranë. Berisha shprehet se dënon disa reagime zyrtare të Athinës, por edhe të Tiranës, që duan të përdorin rastin për qëllime politike. Z.Berisha shprehet se policia ka të drejtën ligjore të kundërpërgjigjet kujtqo që hap zjarr ndaj saj, deri në asgjësimin përfundimtar. Ish-kryeministri i ka shprehur ngushëllimet familjes së viktimës, ndërsa ka dënuar zërat antishqiptarë në Athinë dhe zërat antigreke në Tiranë. Berisha thekson se është e nevojshme të bëhet një hetim transparent për këtë ngjarje dhe të bashkëpunohet midis dy vendeve. "Natyrshisht, në çdo rast që hapet zjarr drejt policisë, kësaj të fundit i lind e drejta ligjore të neutralizojë burimin e zjarrit. Kur them të neutralizojë, nënkuptoj me këtë dorëzimin e kriminelit që hap zjarr, plagosjen e tij dhe së fundi edhe asgjësimin e tij kur dy të parat janë të pamundura. Pavarësisht aktit të dënueshëm që vuri në rrezik forcat e rendit, i shpreh ngushëllime njerëzore familjes së viktimës. Duke dënuar disa reagime zyrtare të Athinës, por edhe të Tiranës, që duan të përdorin rastin për qëllime politike, konsideroj të nevojshme një hetim të plotë dhe transparent të kësaj ngjarjeje. Me këtë rast bëj thirrje për ndërprerjen e histerisë primitive antishqiptare në Athinë dhe asaj antigreke në Tiranë, që nuk i shërbejnë as të vërtetës dhe as bashkëpunimit mes popujve dhe vendeve tona!",



Ish-kryeministri Sali Berisha

**SALI BERISHA**  
"Duke dënuar disa reagime zyrtare të Athinës, por edhe të Tiranës, që duan të përdorin rastin për qëllime politike, konsideroj të nevojshëm një hetim të plotë dhe transparent të kësaj ngjarjeje. Bëj thirrje për ndërprerjen e histerisë primitive antishqiptare në Athinë dhe asaj antigreke në Tiranë!", tha z.Berisha.

**REAGIMI**

Tritan Shehu "I shokuar nga reagimi i Kryeministrit ndaj prononcimit racional, vizionar e stabilizues të Z.Berisha për ngjarjen e Bularatit. Keq përdorimi politik në Athinë e Tiranë i asaj ngjarje, krijimi i histerive armiqësore, është kundër interesave të Shqiperisë, Greqisë e Rajonit", - tha deputeti i PD i qarkut të Gjirokastrës.

**EDI RAMA**  
"Deklarata e Sali Berishës për Bularatin, një pisllek që mund ta bëjë vetëm një materie e biodegraduar deri në palcë. Sa shumë i dha Shqipëria këtij njeriu që do ikë nga kjo botë pa lënë pas goftë edhe një fjali për t'ua treguar fëmijëve apo një fjalim ku të mos duhet sinjali kujdes fëmijët", theksoi z.Rama.

**"Oferta surprizë e Edi Ramës për mua"**

Sandër Lleshi: Çfarë mendoj për Fatmir Xhafajn dhe Saimir Tahirin  
Në studion e emisionit "Opinion", ministri i Brendshëm, Sandër Lleshi ka folur edhe për dy paraardhësit e tij. Duke qenë se prej 5 vitesh ka qenë në pozicionin e Këshilltarit të Kryeministrit për Sigurinë Kombëtare, Lleshi ka pranuar se pjesë e punës së tij ka qenë edhe bashkëpunimi me ministrat e Brendshëm, konkretisht Tahiri dhe Xhafaj. I pyetur se çfarë mendonte për ta, Sandër Lleshi ka heshitur për disa sekonda, ndërsa më pas u shpreh se nuk ishte përgatitur për këtë pyetje. "Nuk isha përgatitur dhe për njerëzit nuk shprehem. Kam mendim pozitiv për të dy. Dihet që zoti Xhafaj e mori ministrinë në një situatë të ndërlikuar. Ka bërë punë pozitive. Për zotin Tahiri e di që ka punuar me dinamizëm dhe aksion të madh. Kurse çdo opinion tjetër duke qenë se është në gjykatë dhe nuk më takon të jap unë mendime", tha Lleshi, duke shtuar, se e kishte marrë vesh propozimin e Ramës vetëm 8 orë para mediave. Përgjatë një interviste në "Opinion", të hënën, Lleshi deklaroi se aktualisht është këshilltar për Mbrojtjen e kryeministrit Edi Rama dhe mbi të gjitha ndan me të vizionin për Shqipërinë. Lleshi: Ishte një ofertë e papritur. E kam marrë vesh të premtën në darkë, tetë orë para jush. Unë s'kam pasur ambicie politike. Unë jam këshilltar i kryeministrit dhe ndaj shumë gjëra me të. Ishte një propozim që unë nuk mund ta kundërshtoja pasi ndaj shumë gjëra me të. Në fakt, unë jam propozuar për ministër i Brendshëm, dhe jo kryepolic i Shqipërisë. Në fushën e sigurisë kombëtare jam i specializuar.



**Vrasja e minoritarit grek**

**Ish-ministri Demiraj: Politika në kurriz të RENEAs, gabim i madh**

Ata që duan të bëjnë politike në kurriz të sigurisë fizike të personelit RENEA bëjnë një gabim të madh dhe i dekurajojnë djemtë e shkelqyer të Forcave Speciale", shkruan ish-ministri, në një shënim në Facebook.  
Te dënuar miq!  
Nuk ka asnjë pikë dyshimi që operacioni i ndërhyrjes së RENEAs ka qenë profesional, i planifikuar sic duhet dhe i zbatuar sipas rrethanave të vendit, kohës dhe forca të kundërveprimt nga kriminelit Kacifas (pasi dihet ngosonat që dallojnë kundër policisë konsiderohen të tillë). Ne të gjitha procedurat operacionale të njesive speciale ne bote, asgjëmi i kriminelit që rrezikon jetën e pjesetareve të njesive është i mbështetur në ligj.  
Ata që duan të bëjnë politike në kurriz të sigurisë fizike të personelit RENEA bëjnë një gabim të madh dhe i dekurajojnë djemtë e shkelqyer të Forcave Speciale, Sigurisht që humbja e jetës së një shtetasi nuk përber një lajm të mirë, por ne kushte të tilla është domosdoshmëri.  
shprehet z.Berisha.  
**REAGIMI**  
Komenteve të ish-kryeministrit Sali Berisha për vrasjen e minoritarit grek në Bularat të Gjirokastrës, kryeministri Edi Rama u është përgjigjur ashpër me një postim në rrjetet sociale, ku e quan paraardhësin e tij "materie të biodegraduar deri në palcë". "Deklarata e Sali Berishës për Bularatin, një pisllek që mund ta bëjë vetëm një materie e biodegraduar deri në palcë. Sa



shumë i dha Shqipëria këtij njeriu, që do ikë nga kjo botë pa lënë pas goftë edhe një fjali për t'ua treguar fëmijëve apo një fjalim, ku të mos duhet sinjali kujdes fëmijët", theksoi z.Rama. Pas përgjigjes së ashpër të kryeministrit Edi Rama ndaj paraardhësit të tij lidhur me komentet për vrasjen e minoritarit grek në Bularat, Berishës i ka dalë në krah lideri i opozitës, Lulzim Basha. Kryetari i Partisë Demokratike, komentet e Ramës i quan "sulm me gjuhë banditi ndaj ish-kryeministrit". Sipas tij, gjithçka bëhet "me shpresën e kotë se mund ta zhvendosë sadopak vëmendjen e mund të fitojë pak kohë për të mbyllur skandalin e radhës". "Bashkëqeverisja e Ramës me krimin është fakt. Bashkëpunimi me krimin për blerje votash është i provuar. Rama nuk ka asnjë shans të mbrojë as veten e as ministrat, ish-ministrat, deputetët e kryebashkiakët kriminelë nga përballja me drejtësinë e vërtetë. Nuk i ka mbetur gjë tjetër veçse të flasë përçart, duke sulmuar me gjuhë banditi ish-kryeministrin, me shpresën e kotë se mund ta zhvendosë sadopak vëmendjen e mund të fitojë pak kohë për të mbyllur skandalin e radhës. Turpi kombëtar ka emrin dhe fytyrën e tij!", theksoi z.Basha.

## NGJARJA NE BULARAT FOTOGRAFITE

Dyshimet për provokim të organizuar. Burimet: Ishte pjesë e një grupi

# Fotot, ekstremisti grek qëllloi me automatik të modifikuar me dylbi

*Konstandin Kaçifa kishte 3 krehra të bashkuar*

Shtohen dyshimet se ekstremisti grek Kostan din Kaçifa ishte pjesë e një plani të parapërgatitur për të krijuar tension në jug të Shqipërisë. Burime nga Bularati bëjnë të ditur se plumbat mbi Policinë e Shtetit mendohet të kenë qenë një incident i planifikuar që më parë. Dyshimet janë se Kaçifa ishte pjesë e një komandojë të armatosur që ka mësyre në kufirin shqiptar për të shkaktuar akte terrori në vend.

Në videon e publikuar nga mediat, shihet se Kaçifa mban në dorë një kallash të modifikuar me 3 krehra të bashkuar, i veshur me uniformë ushtarake. Kjo të bën të mendosh se viktimat që u vra nga RENE A e kishte paramenduar aktin e tij të goditjes së policisë shqiptare. Gazetari investigativ deklaroi dje se Kaçifa nuk veprroi vetëm. S'ishte vetëm. Por kur panë RENE A-n, dronët dhe helikopterët, u trembën. Ka qenë skenar, sepse ai s'veproi i vetëm. Kur i shihet syri rrezik, vepronte. S'ishte fshatar i thjeshtë. Askujt s'i bëhet qejfi për jetën e një njeriu, por askush se dinte çfarë do ndodhte. Nuk dihej nëse do ndihmohej sërisht nga persona të armatosura. Në pamundësi të negociatave dhe të një zgjidhjeje tjetër, Forcat Speciale e neutralizuan. Ai u ndihmu nga të tjerë. Ku janë të tjerët që hynë në Shqipëri me Kaçifin?", deklaroi ai.

Në këto foto shihet 35-vjeçari, i veshur me uniformë ushtarake dhe me një automatik në dorë teksa qëllon në drejtim të automjetit të policisë në qendër të fshatit Bularat. Pamjet janë regjistruar me celular nga brenda lokalit, ndërsa dëgjohen edhe disa të shtëna.

### NGJARJA

Në prag të zhvillimit të festes së Greqisë, e cila si çdo vit u organizua edhe në qendër të fshatit Bularat në Gjirokastrë, të shtëna me armë tronditën zonën. Policia, e cila ishte stacionuar në qendër të fshatit për mbarëvajtjen e festës menjëherë është nisur në drejtimin nga janë dëgjuar të shtënat, ndërsa identifikoi edhe personin që qëlloi me armë. Kostandin Kaçifa sapo ka parë shërbimet e policisë që po afroreshin në drejtim të tij ka hapur zjarr me breshëri ndaj punonjësve të policisë duke rrezikuar jetën e tyre.

Fatmirësisht nga të shtënat nuk pati punonjës policie të plagosur, por vetëm



35-vjeçari, i veshur me uniformë ushtarake teksa qëllon në drejtim të automjetit të policisë në qendër të fshatit Bularat



është thyer xhami i mjetit të policisë. Policia menjëherë ka rrethuar zonën ku përsëri ky shtetas ka hapur zjarr në drejtim të punonjësve të policisë që po e ndiqnin. Shtetasi Kostandin Kaçifa u fut në thellësi të fshatit ku forcat "Shqiponja" dhe shërbimet e tjera të Drejtorisë Vendore të Policisë vijuan krehjen e zonës për të bërë të mundur kapjen e tij.

Në ndihmë të shërbimeve të Policisë së Gjirokastrës shkoi dhe një helikopter i Ministrisë së Brendshme dhe forcat speciale RENE A nga Tirana, të cilat bënë të mundur edhe lokalizimin e autorit. Por pasi nuk iu përgjigj thirrjes së policisë për t'u dorëzuar, 35-vjeçari qëllonte me armë zjarri, ndërkohe mbeti i vvarë.



**TIRANË** - Arrestimi pak ditë më parë i 45-vjeçarit italian në Tiranë, i cili kërkohet nga drejtësia italiane për dhunë seksuale ndaj të miturve ka nxjerrë në dritë një të vërtetë tronditëse. Masimiliano Croce, i dënuar në vendin fajnë me vendim të formës së prerë me 16 vite burg pasi ka abuzuar seksualisht me fëmijë të varfër e jetimë, të cilëve iu jepte mësim në Romë, dyshohet se ka abuzuar seksualisht edhe me 2 fëmijë shqiptarë. Burime nga policia thanë për 'News 24' se 45-vjeçari italian jetonte prej 2 vitesh në periferi të Tiranës ku bashkëjetonte me një grua, e cila kishte dy fëmijë, më i madhi 14 vjeç. Pas prangosjes së Croces, blutë kanë marrë në pyetje gruan së bashku me 2 fëmijët. Në prani të psikologes, të miturit kanë treguar se janë ngacmuar e abuzuar seksualisht

## Ndërpritën procedurat për ekstradimin e 45-vjeçarit

# U arrestua në Tiranë, pedofili italian ka abuzuar edhe me dy fëmijë shqiptarë



Masimiliano Croce

nga 45-vjeçari. Ndërsa, gruaja ka deklaruar se nuk ka qenë në dijeni as për abuzimin me fëmijët e saj as për të shkuarën e errët të italianit. Ajo ka treguar për uni-

format blu se ai sillte mirë me fëmijët dhe e ndihmonte financiarisht për të përballuar jetesën. Momentalisht policia po kryen hetime të thelluara, por nuk ka sigu-

ruar asnjë provë që të fajsojë gruan si bashkëpunëtore. Në lidhje me këtë rast janë ndërprerë procedurat e ekstradimit të 45-vjeçarit, pasi ai do të hetohet për veprën penale të dhunës seksuale ndaj të miturve në Shqipëri. Masimiliano Croce në vitin 2017 është dënuar nga gjykata italiane me vendim të prerë me 16 vite burgim për veprën penale: "dhunë seksuale ndaj të miturve". Croce kishte mundur t'u shpëronte prej katër vitesh autoritetve italiane, ndërsa u prangos në periferi të kryeqytetit më 24 tetor pas një bashkëpunimi mes policisë italiane dhe asaj shqiptare.



### SHKURT

#### Stresi heq dorë nga ankimi për masën: Dua të rri në burg!

**TIRANË** - Pasi kërkoi ndryshim të masës së sigurisë 'Arrest me burg', Arkimed Lushaj heq dorë nga ankimi. Këngëtar i njohur i repit, u arrestua, pasi akuzohet se ka qenë pjesë e një bande kriminale si dhe për armëmbajtje pa leje. Mësohet se Stresi, kërkoi nëpërmjet avokatit të tij që mos të zhvillohej gjyqi, me pretendimin se nuk kishte besim tek drejtësia shqiptare. "Dua të rri në burg, pasi nuk kam besim të drejtësia", është shprehur Lushaj që u arrestua mbrëmjen e 17 tetorit në një hotel në periferi të Tiranës. Policia gjeti dhe një armë si dhe një sasi kokaine. Por, familja e tij ka hedhur poshtë çdo akuzë për të duke e cilësuar arrestimin politik.

#### Iu gjet 2 kg kokainë në makinë, bien në pranga 2 të rinjtë

**DURRES** - Në vijim të operacioneve për kapjen e personave të përfshirë në krim të organizuar e trafik droge, policia ka ndaluar dy persona në Durrës. Aksioni u zhvillua mbrëmjen e së dielës tek zona e quajtur "Ura e Dajlanit". Pas një hetimi 2 muajor, policia arriti të vërë në pranga shtetasit: Taulant Lala 29 vjeç dhe Adnan Bufi 22 vjeç, të dy banues në Shkozot, Durrës. Dy të rinjtë iu gjet dhe iu sekuestrua 2 kg kokainë. Mësohet se lënda narkotike u gjet gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin tip "BMW" që drejtohej nga Lala.





Presidenti i Republikës, Ilir Meta dhe në Stamboll, në përurimin e aeroportit të madh të këtij qyteti "Istanbul Ataturk Airport"

Presidenti në Stamboll me ftesë të veçantë, hapet aeroporti më i madh i Turqisë

# Erdogani bën bashkë Metën, Thaçin dhe Vuçiçin në Stamboll

## Meta takon Erdoganit: Kënaqësi e veçantë

Valentina Madani

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ndodhet në Stamboll, me ftesë të veçantë nga Presidenti i Republikës së Turqisë, Rexhep Taip Erdogan për të marrë pjesë në përurimin e aeroportit të madh të këtij qyteti "Istanbul Ataturk Airport". Presidenti turk, Rexhep Taip Erdogan inauguroi aeroportin e ri të Stambollit, i cili pas përfundimit të plotë në vitin 2023, pritet të jetë aeroporti më i madh në botë. Simbolika e këtij përurimi përkon me 95-vjetorin e themelimit të Republikës së Turqisë. Mbi 50 zyrtarë të lartë nga të paktën 18 shtete, kryesisht Europa Juglindore, Azia dhe Afrika, morën pjesë në ceremoninë e inaugurimit. Në mesin e liderëve të shumtë ishin edhe Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta; Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, Presidenti i Maqedonisë, Gjorge Ivanov dhe Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç. Nuk dihet ende nëse ka pasur takime mes liderëve, por nga video e transmetuar drejtpërdrejt nga ceremonia e inaugurimit u pa qartë që autoritetet turke janë kujdesur që Thaçin dhe Vuçiçin t'i ulin jo afër një-tjetrit. Ndërkohë që Meta, Thaçi dhe Ivanov qëndruan bashkë në të majtë të Erdogan. Vuçiç ishte ulur në të djathtë. Agjencia turke e lajmeve, "Anadolu Agency" tha se hapja e fazës së parë të aeroportit u organizua me rastin e 29 Tetorit, Ditës së Republikës në Turqi. Faza e parë e aeroportit do të ketë kapacitet për 90 milionë pasagjerë në vit, tha Erdogan, duke shtuar se "kjo shifër do të rritet në 150 milionë, nëse nevojitet edhe në 200 milionë, pas përfundimit të të gjitha fazave deri në vitin 2028". Aeroporti është ndërtuar në një hapësirë prej 76,5 milionë metra katrorë, ndërsa për hapjen e fazës së parë janë investuar gjashtë miliardë euro. Faza e dytë pritet të përfundojë deri në vitin 2023, ndërsa e treta dhe e fundit në vitin 2028. "Pas përfundimit të punëve, aeroporti do të përbëhet nga gjashtë pista të ndara me një kapacitet për 500 avionë, parking të hapur dhe të mbyllur me kapacitet



Rruga e Arbrit, janë kryer mbi 20% e punimeve

## Rama, në aksin Vorë-Fushë Krujë: Të zgjidhet çështja e ujit në autostradë

Kryeministri Edi Rama inspektoi dhe akset ku po kryhen punimet në disa rrugë, të cilat do të krijojnë një rrjet gjarpërues në të gjithë Shqipërinë. Shefi i qeverisë pa nga afër punimet në aksin Vorë-Fushë Krujë, të cilat siç tha edhe ai, po ecin me ritmet të shpejta dhe me standartet e duhura. Programi i Rindërtimit vijon intensivisht në gjithë akset problematike të vendit, ku sipas Ramës nuk u vu dorë prej dekadash. "Ky është rindërtim goxha i thellë dhe i domosdoshëm, sepse ishte një nga akset më të shpartalluar, ndërkohë që është



aks kombëtar, për momentin, deri kur të ndërhyjmë në mënyrë rrënjësore me ndërtimin e të gjithë rrugës së re Kashar-Thumanë, pastaj lart deri në Ballëdrin

dhe të krijojmë një rrugë të standardeve siç dimë ne", tha z.Rama. Në bashkëbisedim me përfaqësuesit e firmës ndërtuese, Rama deklaroi se duhet të zgjidhet njëherë e mirë situata e përmytjes pranë zonës së Kasharit. Ndërsa për Rrugën e Arbrit, kryeministri tha se po ecën me ritme shumë të kënaqshme. Deri tani janë kryer mbi 20% e punimeve. "Të krijojmë një rrugë të standardeve siç dimë ne, jo siç i bënit ju. Edhe Rrugë e Arbrit po ecën shumë mirë. Të zgjidhet situata e ujit në autostradën e Kasharit", deklaroi kryeministri Rama.

### DEKLARATA

"Kënaqësi e veçantë ta uroja Presidentin e Republikës së Turqisë, Rexhep Taip Erdogan për 95-vjetorin e themelimit të Republikës së Turqisë e njëkohësisht për inaugurimin e aeroportit të madh "Istanbul Ataturk Airport", u shpreh Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta.

## Denoncimi, ish-të përndjekurit që në 5 të mëngjesit në radhë për dëmshpërblimit

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dhe mesazhin e një qytetari dixhital, ku ky i fundit denoncon sjelljen e administratës me ish-të përndjekurit politikë. Sipas qytetarit dixhital, i cili i ka dërguar Berishës edhe një video, dhe që prej orën 5 të mëngjesit shumë ish-të përndjekur kanë ndenjur në radhë për të dorëzuar dokumentet për të përfituar kështu e tretë të dëmshpërblimit. "Shteti shpartalline!

Lexoni mesazhin dhe shikoni videon e qytetarit dixhital. sb

Doktor Berisha. Me qindra të përndjekur politikë sot (dje) qysh në orën 5 të mëngjesit për të dorëzuar dokumentet, apo për t'u sqaruar për dokumentacionin e përfitimt të kështu të tretë. Askush nuk të sqaronte, përveç britmave the shtyrjeve të kësaj administrate të kalbur dhe militantave e Rilindjes", thuhet në mesazhin dërguar z.Berisha.

## Zv.presidentja e Senatit Francez, takime në Tiranë

Jam e impresionuar nga puna intensive e kryer nga qeveria Rama", si dhe lëvizjet e guximshme në luftën ndaj korrupsionit". Kështu deklaroi dhe senatorja Hélène Conway Moutret, e cila mban postin e zv.presidentes së Senatit Francez dhe anëtarës së Komisionit të Marrëdhënieve me Jashtë, Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura. Gjatë vizitës së saj në Tiranë, Moutret pati një axhendë të ngjeshur takimesh me aktorë të politikës shqiptare. Gjatë takimit me Sekretariatit e Partisë Socialiste, Moutret u shpreh se ndihet e impresionuar lëvizjet e guximshme të kryeministrit dhe kabinetit të tij në luftën ndaj informalitetit, korrupsionit, si dhe përgëzoi qeverinë për fokusin e vendosur në agro-turizëm, arsim profesional dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

### Njoftim për shitje me ankand të tretë

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e tretë për pasurinë e dorezuesin K Sula të ndodhur në Mallakastër . Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga :  
\* Pasuria "Ari" me nr. 206/46, me sipërfaqe 2500 m<sup>2</sup>, nr ZK 2969 vol. 5 fq 31, dhe "Ari" me nr.206/7 me vol 4, faqe 244, nr ZK 2969 vol me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup>.  
Ankandi tretë i sipërfaqes totale 3.000 m<sup>2</sup> fillon me cmin fillëstar 806.400 lekë  
\* Pasuria "Ndertesë" pjesë e veuar me nr. 70/15, vol 6, faqe 85 me sipërfaqe 51 m<sup>2</sup> e ndodhur nr ZK 2969 Ankandi tretë fillon me cmin fillëstar 252.419 lekë  
Ankandi është progresiv dhe do të zhvillohet dt 23.11.2018 në orën 15:00 në Bulv "G.Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra 5. Kont tel. 0672082543, e-mailit ilir\_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com.

### Njoftim për shitje me ankand

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar ne nenin 567,568 e vijues te K.P.LC do te zhvillojë ankandin e pare për pasurinë e pales debitore B Kamberaj dhe L Kamberaj, Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga :  
\* "Trulli" e Godine tre katëshe", me numer pasurie 14/283 ne Z K Nr.8602, volumi 35, faqe 144, trulli 300 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e kati perthe 117.9 m<sup>2</sup> ne Lagjen 10 Korrikune Vlore  
Ankandi i pasurisë fillon me cmin fillëstar në masën prej 8.960.000 Lekë  
Ankandi qendron i hapur 15 dite dhe do të zhvillohet në datë 08.11.2018 në orën 15:00 në Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 2,Tiranë Ofruesit duhet të tërhiqin dokumentacionin të kontaktojnë me tel. 00355 67 20 82 543 ose e-mailit ilir\_dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com.

## KANCERI I GJIRIT

### INTERVISTA

Voltiza Duro

Tetori është muaji i ndërgjegjësimit në luftën kundër kancerit të gjirit, në një kohë që në vendin tonë ende nuk ka një regjistër kombëtar për identifikimin e saktë të pacienteve. Shqetësimi ngrihet nga Donjeta Zeqa, kreu i organizatës "Europa Donna Albania", e cila në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" thekson se kjo problematikë nuk po merr zgjidhje. Zeqa thekson se deri më tani nuk ka të dhëna të sakta për numrin e rasteve të reja dhe numrin total të rasteve, por shton se nga viti 2014 në vitin 2015, numri i pacienteve me kancer gjiri është dyfishuar. Ndërkohë, kreu i EDA bën me dije se ka ende raste që mungojnë medikamentet për trajtimin e pacienteve me kancer gjiri, por jo më problematike siç ka qenë më parë.

#### Cili është misioni i organizatës "Europa Donna Albania"?

"Europa Donna Albania" është pjesë e organizatës ombrellë "Europa Donna", e cila është një organizatë jofitimprurëse, e përbërë nga organizata anëtare në të gjithë Evropën. Ky koalicion organizatash punon për të rritur ndërgjegjësimin e kancerit të gjirit dhe për të mobilizuar mbështetjen e grave evropiane për të ushtruar më shumë presion për përmirësimin e edukimit lidhur me kancerin e gjirit, diagnostikimin dhe trajtimin e përshtatshëm dhe gjenerimin e fondeve për kërkime shkencore. "Europa Donna Albania" përfaqëson interesat e grave shqiptare lidhur me parandalimin dhe mbrojtjen nga kanceri i gjirit përballë institucioneve shëndetësore dhe autoriteteve publike, të cilat e kanë për detyrë të realizojnë këtë. "Europa Donna Albania" u krijua në vitin 2009 nën ombrellën e organizatës "mëmë", por në 2013-ën bëri një pauzë trevjeçare. Dhe në vitin 2016, EDA ka rifilluar aktivitetin e saj me ndryshime në bord dhe në drejtim.

#### Sa pacientë numri i pacienteve që janë pjesë e organizatës suaj dhe cilat janë shërbimet që ofron për to?

EDA është një organizatë me anëtarësi ku shumicën e anëtarëve i ka pacientë, por jo vetëm. Anëtar mund të jetë kushdo që ka dëshirë të ndry-

Kreu i "Europa Donna Albania": Zbehet shqetësimi i mungesës së medikamenteve

# Donjeta Zeqa: Mungon regjistri kombëtar për evidentimin e pacienteve me kancer gjiri

"Problematika vazhdon, nuk ka të dhëna të sakta për rastet e reja"

#### NUMRI I PACIENTEVE ME KANCER GJIRI

Kjo është një tjetër problematikë për të cilën e kemi shfaqur shpesh në si organizatë. Në Shqipëri nuk ka një Regjistër Kombëtar të Kancerit të Gjirit dhe nuk ka të dhëna të sakta për numrin e rasteve të reja dhe numrin total të rasteve, por ajo që dimë është se nga viti 2014 në vitin 2015, numri i pacienteve me kancer gjiri është dyfishuar.



Donjeta Zeqa, kreu i organizatës "Europa Donna Albania"

#### AKTIVITETET

"Europa Donna Albania" organizon aktivitete të ndryshme gjatë gjithë vitit, por kulmon në muajin tetor, duke qenë se edhe vëmendja e mediave është më e madhe gjatë tetorit. Në kemi organizuar aktivitete dhe takime me gratë me kancer gjiri në ambientet e "Onkologjikut". Në Ditën e Shëndetit të Gjirit kemi bërë një aktivitet "Pedalo për gratë me kancer gjiri", që ka si qëllim që të nxisë çdo vajzë e grua të bëjë një jetesë të shëndetshme.

## ORGANIZATA EDA

EDA është një organizatë me anëtarësi ku shumicën e anëtarëve i ka pacientë, por jo vetëm. Anëtar mund të jetë kushdo që ka dëshirë të ndryshojë jetën e grave me kancer gjiri. Numri i pacientëve ndryshon çdo ditë, ashtu siç edhe numri anëtarëve është në rritje.

përmirësojmë jetesën e këtyre grave në të gjitha mënyrat e mundshme duke përfshirë dhe elementin "argëtim", sepse një grua me kancer ka të drejtën të jetojë si çdo njëri tjetër.

#### Këtë vit, a ka pasur mungesë medikamentesh për pacientet që vuajnë nga kanceri i gjirit?

Ka raste që mungojnë, por tani më nuk flasim më për ato mungesat e gjata. Problem neget më shumë fakti që ne ende flasim për medikamente aktuale dhe problematike që janë prej kohësh, por bota po fut medikamente të reja, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e pacienteve.

Sipas statistikave, sa është numri i pacienteve

në rritje, ndaj është shumë e rëndësishme që vajzat dhe gratë të bëjnë kontrolle të herëpashershme, në mënyrë që ta kapin në kohë këtë sëmundje.

#### Sa të ndërgjegjësuara janë vajzat e gratë shqiptare për kancerin e gjirit?

Unë kam thuar se tri vite që merrem me organizatën, por kam gati 20 vite që e di se çfarë është kjo sëmundje, për shkak dhe të eksperiencave familjare. Nëse flas për ndryshimin e mentalitetit të vajzave dhe grave nga momenti kur unë kam filluar të merrem intensivisht me organizatën, më duhet të them që ka ndryshuar goxha. Në këtë kemi si qëllim që ato t'i ndërgjegjësojmë para se situata të shkojë tek mastektomia dhe kimioterapia. Ajo çka vërej si shqetësim tek vajzat dhe gratë shqiptare është përgjigja pas analizave. Pra, ngurojnë të vizitohen nga frika se çfarë do dalë më pas. Është shumë e rëndësishme që vajzat dhe gratë të kujdesen për shëndetin e tyre. Vetë termi "kancer" të tremb, më tremb edhe mua që merrem çdo ditë me këtë punë, por nuk mund ta lëmë frikën tonë të brendshme të rrisë brenda nesh një "monster". Ndaj

bëni vizita, hani shëndetshëm dhe shmangni stresin. Në Shqipëri, vajzat e gratë e neglizhojnë shumë veten, kanë sensin e "vetësakrifikimit" për familjen, duke lënë veten dhe shëndetin e tyre pas dore.

#### Cilat janë disa prej aktiviteteve që keni organizuar për gratë këtë muaj sensibilizues?

"Europa Donna Albania" organizon aktivitete të ndryshme gjatë gjithë vitit, por kulmon në muajin tetor, duke qenë se edhe vëmendja e mediave është më e madhe gjatë tetorit. Në kemi organizuar aktivitete dhe takime me gratë me kancer gjiri në ambientet e "Onkologjikut". Në Ditën e Shëndetit të Gjirit kemi bërë një aktivitet "Pedalo për gratë me kancer gjiri", që ka si qëllim që të nxisë çdo vajzë e grua të bëjë një jetesë të shëndetshme. Në këtë pedalin morën pjesë të rinj dhe mjekë e aktivistë të shoqërisë civile. Gjithashtu, gjatë muajit kemi pasur dhe fushatën "Dhuro flokë, fal shpresë", e cila përmbylli edhe aktivitetet e këtij muaji me një aktivitet ditën e shtunë, ku vajza të reja dhuruan flokë të tyre për gratë me kancer gjiri. Flokë të cilat do të përpunohen më pas në paruke dhe do u dhurohen këtyre grave.



Vitin e ardhshëm do të fillojë përdorimi i flotës së autobusëve elektrikë, çka do të lehtësojë transportin publik në kryeqytet dhe do të krijojë mundësinë e uljes së nivelit të ndotjes. "Vitin tjetër do fillojmë me autobusët elektrikë. Është një mënyrë shumë më komode për të përdorur transportin publik, sidomos tani që po bëjmë linjat e dedikuara jo vetëm për biçikletat, por duke filluar në Unazë edhe për autobusët. Nëse doni të lëvizni në Tiranë, është më mirë të përdorni një biçikletë", tha kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj.

## Prezantohet "Guida studentore" për studentët e rinj

### Veliaj: Viti 2019 vjen me flotën e autobusëve elektrikë, lehtësi në transport

**KRYEBASHKIAKU**  
 "Vitin tjetër do fillojmë me autobusët elektrikë. Është një mënyrë shumë më komode për të përdorur transportin publik, sidomos tani që po bëjmë linjat e dedikuara jo vetëm për biçikletat, por duke filluar në Unazë edhe për autobusët. Nëse doni të lëvizni në Tiranë, është më mirë të përdorni një biçikletë", tha kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj



Kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj

sport dhe më shumë para në xhep. Mezi pres të vijë 1 janari, që të lirohen edhe hapësirat e zëna me pika e biznese të tilla në Qytetin 'Studenti'. Ato janë para që mund të shpenzoheshin shumë më mirë me sport, aktivitete, ekskursione", u

shpreh Veliaj.  
**"GUIDA STUDENTORE"**  
 Bashkia e Tiranës e ka kthyer në traditë "Guidën Studentore", broshurën me informacione të vyerë për qytetin që u shpërndahet studentëve të rinj, të cilët

vijnë në Tiranë me fillimin e universitetit. Studentët që kanë ardhur në Tiranë për të ndjekur studimet e larta do të marrin edhe një broshurë mirëseardhjeje nga Bashkia e Tiranës, e cila do t'u shërbejë si një guidë për të njohur qytetin. Veliaj

i njohu banorët më të rinj të Tiranës me disa nga mundësitë e shkëlqyera që ofron kryeqyteti, jo vetëm për të kaluar kohën e lirë, por edhe për t'u angazhuar në projekte apo aktivitete vullnetare. Ai nënvizoi se Tirana sot ofron çdo ditë ak-

tivitete të ndryshme sportive dhe kulturore, duke i dhënë mundësi gjithkujt të gjejë veten e tij. Ndaj, Veliaj ftoi studentët e rinj që të frekuentojnë Parkun e Liqenit, Amfiteatrin e rindërtuar, apo aktivitete të tjera që organizohen në kryeqytet.

Urdhri i Infermierëve të Shqipërisë: Verifikoni të dhënat, kryeni reregjistrimin

# Zbardhen emrat e 60 punonjësve të shëndetësisë, që do të rristojnë aftësitë profesionale

## Përsëritje e provimit VAP për infermierët, fizioterapistët e mamitë

Voltiza Duro

Rreth 60 punonjës shëndetësie duhet t'i nënshtrohen sërish testimit për të marrë licencën që u jep të drejtën e ushtrimit të profesionit. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listat me kodet e praktikantëve që duhet të paraqiten për t'u reregjistruar për testim në Praktikën Profesionale me Mbikëqyrje si dhe provimin e Vlerësimit të Afësisimit Praktik (VAP). "Tu njoftojmë se të gjithë kandidatët që kanë të shënuar kodin e kartës së praktikantit në këtë listë, duhet të përsërisin Praktikën Profesionale me Mbikëqyrje si dhe provimin e Vlerësimit të Afësisimit Praktik (VAP), pra të reregjistrohen për përsëritjen e praktikës në zyrat ku kanë bërë regjistrimin fillestar. Verifikoni të dhënat tuaja", theksohet në njoftimin e publikuar në faqen zyrtare të Urdhrit të Infermierëve të Shqipërisë.

**PROCEDURA**  
 Për të gjithë ata që janë përsëritës në Provimin e Shtetit, do të bëhet edhe konfirmimi i pjesëmarrjes në sezonin e radhës, duke dorëzuar: kërkesën me shkrim për pjesëmarrje në këtë provim, ku do të përcaktojnë saktë për të satën herë hyjnë në Provim Shteti. Gjatë vitit 2012, Urdhri i Infermierit ndryshoi kushtet për të gjithë kandidatët që dëshironin të hynin në provimin e shtetit. Sipas këtyre ndryshimeve, të interesuarit, përveç praktikës profesionale, i nënshtrohen në fund



të saj, ndërkohë që vetëm nëse vlerësohen pozitivisht në të, kanë të drejtë të regjistrohen për provimin e shtetit. Konkretisht, studenti i diplomuar në programet e studimit të sipërpërmendura, ditën që regjistrohet, merr librezën e praktikës profesionale. Në këtë librezë mbahen shënimet ditore përgjatë 12 javëve që studenti realizon praktikën, të cilat firmosen çdo ditë

nga drejtuesi i saj. Në fund, librezë e firmosur nga drejtuesit vlerësohet me një numër pikësh të caktuara. Saktësisht, ato janë nga 10 deri në 25 pikë, të cilat i njihen kandidatit gjatë realizimit të testimit profesional. Ai e merr librezën dhe 10 ditë para datës së provimit e dorëzon atë pranë Urdhrit Profesional dhe regjistrohet për dhënie të testimit profesional.

### EMRAT E PUNONJËSVE TË SHËNDETËSISË, QË DO TË RITESTOJNË AFTËSITË PROFESIONALE

INFERMIER			
Kodi	Kodi	Kodi	Kodi
0060360	0080383	0051069	0050746
0050764	0116073	0050891	0113359
0115816	0120928	0090322	0010705
0115631	0070633	0090327	0060318/1
	0116311	0051071	0100963
	0060358	0060376	0115221
	0115941	0115378	0090323
	0120925/1	0115600	0120979
	0051076	0060344/1	0070956
	0120436	0050817	0120976
	0114431	0100389	0051074
	0070888	00411662	00411858
	0010734	00411715	0030821
	0010741	0120784	0070470

FIZIOTERAPI
Kodi
0030803
0115486
0051070
0116233
0115709
0116172
0114983
0116232

MAMI
Kodi
0020324
0051045

TEKNIK LABORATORI
Kodi
0116318

# BalkanWeb.com

**AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.**



**MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ  
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET**



**INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET  
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR  
QR CODE APPLE DHE ANDROID**

**BalkanWeb.com**  
**BW**

**FALAS**





Ish-ministri i Brendshëm dorëzoi dje vendimin te Krimet e Rënda



TIRANE

# Trafiku i drogës me Habilaj, prokuroria e Katanias mbyll hetimet për Tahirin

"Nuk ka elementë të përshtatshëm për të mbështetur akuzën"

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri ka depozituar mesazhin e dëshmitë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda vendimin e gjykatës italiane të Katanias për mbylljen e çështjes në ngarkim të tij me akuzën e trafikut të drogës. Ai u paraqiti tek Krimet e Rënda bashkë me avokatin e tij Maks Haxhia, në orën 13:00, ndërsa doli prej aty vetëm pa çaste më vonë. Jashtë ambienteve të organit të akuzës, Tahiri u tha gazetarëve se kishte paraqitur disa deçizive për procesin. "Paraqita disa deçizive për procesin, por do kërkoj mirëkuptimin tuaj. Do flas pas 2-3 ditësh më konkretisht, ndaj më vjen keq që keni ardhur", u shpreh ish-ministri. Ndërkohë, pyetjes nëse ai ka frikë se do të merret i pandehuri, Tahiri iu përgjigj shkurt: "Nuk kam frikë. Kam mbi një vit që dëgjoj pafundësisht dhe kam heshtur, prisni ju dy ditë". Ndërkaq, "Gazeta Shqiptare" ka siguruar dosjen e plotë me hetimin e kryer nga Prokuroria e Antimafias në Itali dhe vendimin e marrë nga Gjykata e Katanias. Referuar vendimit, rezultojnë që Saimir Tahiri ka qenë në hetim nga prokuroria italiane prej datës 27 tetor të vitit të kaluar nga prokuroria e Katanias me akuzën e trafikut të drogës mbi bazën e përgjimeve të çështjes Habilaj. Në përgjime flitej për 30 mijë euro që grupi Habilaj kishte për t'i dhënë një personi me emrin Saimir dhe bizhuteri gruas së tij. Pas hetimeve prej më shumë se një viti prokuroria e vendit fqinj shkruan se nuk ka gjetur prova që implikojnë ish-ministrin e Brendshëm shqiptar, duke kërkuar arkivimin ose mbylljen e çështjes. Vendimi është marrë nga Gjykata e Hetimeve Paraprake në tetor, ndërsa çështja në ngarkim të Habilajve vijon në Katania, pasi hetimi për Tahirin ishte i veçantë.




Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri

## DEKLARATA E TAHIRIT

Jashtë ambienteve të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Tahiri u tha gazetarëve se kishte paraqitur disa deçizive për procesin. "Paraqita disa deçizive për procesin, por do kërkoj mirëkuptimin tuaj. Do flas pas 2-3 ditësh më konkretisht, ndaj më vjen keq që keni ardhur", - u shpreh ish-ministri. Ndërkohë, pyetjes nëse ai ka frikë se do të merret i pandehuri, Tahiri iu përgjigj shkurt: "Nuk kam frikë. Kam mbi një vit që dëgjoj pafundësisht dhe kam heshtur, prisni ju dy ditë".

përgjimeve, veçanërisht ku përmend se duhet t'i japë 30.000 euro një "Saimir" ose në pjesët ku flet për blerjen e disa bizhuterive për bashkëshorten dhe të ëmën e Saimir Tahirit, në vlerë-

simin e prokurorisë, në mungesë të përgjigjeve të vlefshme nuk ekzistojnë elementë të vlefshëm për të ngritur akuzë në gjyq", - thuhet në deklaratën e prokurorit të Antimafias italiane. Në



Faksimile e vendimit

19.03.2018, vetë Prokurori i Republikës konfirmoi kërkesën e prokurorit të Antimafias për mbylljen e hetimeve ndaj Tahirit duke hapur rrugë kështu vendimit të gjykatës. "Gjykata, duke vlerësuar kërkesën e prokurorit dhe duke pranuar në mënyrë të plotë argumentet e prokurorit, në bazë të nenit 409-411 KPP, vendos mbylljen e hetimit për çështjen në shqyrtim dhe depozitimin e akteve pranë

prokurorisë", vendim i cili është marrë nga gjykata italiane e Katanias më 5 tetor, bazuar në kërkesën e prokurorit të Antimafias. Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri është vënë nën hetim nga Prokuroria e Antimafias italiane në dt. 27.10.2017. Me mbylljen e hetimeve në Itali, ish-ministrin të Brendshëm i mbeten të hapura hetimet në Shqipëri, afati i të cilave u shty së fundi deri në janar 2019.



**'Për shqiptarët ka simpati të veçantë', Ndoka takon Salvinin**

Kreu i Partisë Demokratike shqiptare njoftoi dje se ka takuar në Romë, zv.kryeministrin dhe ministrin e Brendshëm të Italisë, Matteo Salvini. Lajmin e bëri të ditur vetë Ndoka me anë të një postimi në Facebook, ku edhe shkruan se kryefjala e takimit me Salvinin ishte situata politike në Shqipëri. Ndër të tjera, kreu i Partisë Demokratike publikoi edhe foto të librit që Salvinin i kishte dhuruar me një autograf të dedikuar për të. Të shumtë kanë qenë edhe komentet e ndjekësve të Ndokës, të cilët kanë komentuar edhe qëndrimet e Salvinit, komentet të cilave Ndoka iu është përgjigjur me: "Për shqiptarët Salvinin ka simpati të veçantë".

## Paloka: Skenar i paralajmëruar i Ramës

### 'Provat e reja', PD: Rama skenar për të mbyllur çështjen e Tahirin

Partia Demokratike akuzoi dje kryeministrin Rama se ka gati skenarin për mbylljen e çështjes së ish-ministrin të Brendshëm, Saimir Tahiri, të cilin opozita e akuzon për trafik të lëndëve narkotike. Sipas nënkryetarit të demokratëve, Edi Paloka, provat e reja të paralajmëruara nga Tahiri pas daljes nga prokuroria kanë të bëjnë me një dokument përmes të cilit ish-ministri i Brendshëm provon se nuk është nën hetim në Itali, ku po gjykohej banda e "Habilajve". "Dorëzimi i gjoja provave të reja nga Saimir Tahiri është pjesë e skenarit të Edi Ramës për të



përgatitur opinionin publik për mbylljen e çështjes së Saimir Tahirit. Këtë që ka bërë sot Saimir Tahiri, e ka

paralajmëruar Edi Rama më 16 tetor, kur njoftoi se cili do të jetë fati i dosjes "Tahirin". E ashtuqajtura provë e re që paraqiti sot si lajm Saimir Tahiri është fakti se në Itali ai nuk është nën hetim. Kjo është alibia që Edi Rama i dha Saimir Tahirit dhe pas së cilës fshihet presioni që po i bëhet prokurorisë për të mbyllur çështjen. Është fakt se Saimir Tahiri po hetohet nga prokuroria shqiptare për krime të kryera në territorin shqiptar. Është fakt se shteti italian nuk mund të hetojë një shtetas shqiptar që kryen krim në territorin shqiptar", -tha Edi Paloka.

## PARALAJMËRIMI I KRYEMINISTRIT EDI RAMA MË 16 TETOR, KUR NJOFTOI SIPAS PALOKËS SE CILI DO TË JETË FATI I DOSJES 'TAHIRI'.

- Erl Murati:** A erdhi dosja nga prokuroria në parlament, që e votove dhe e rrëzove për arrestimin e ministrin të Brendshëm?
- Edi Rama:** Po mirë po si shpjegohet që, sot e gjithë ditën ajo dosja e famshme e atij procesi që bëhet në Itali dhe nuk bëhet këtu, nuk rezultojnë asgjë për ministrin e Brendshëm
- Erl Murati:** Atë do ta thotë gjykata.
- Edi Rama:** Po e ka thënë gjykata.
- Erl Murati:** Po do ta thotë gjykata.
- Edi Rama:** Po e ka thënë mor në Itali.
- Erl Murati:** Për kë po flet?
- Edi Rama:** Për atë mo për atë dosjen që thua ti, dosjen që e rrëzuan ne.
- Erl Murati:** Cilin pra?
- Edi Rama:** Për atë dosjen e Saimir Tahirit po them. Si shpjegohet?
- Erl Murati:** Vazhdon pra, janë shtyrë hetimet e prokurorisë këtu në Tiranë.
- Edi Rama:** Ore, po flas për Italianë unë, lëre në Tiranë. Në Itali! -tha Edi Rama në 16 tetor 2018.

"Sa shumë urrejtje paske në shpirt, keq më vjen për ata që ke afër"

# Sherret më të bujshme mes VIP-ave shqiptarë, zbuloni reagimet e tyre

Miqësitë që morën fund nga fjalët e tepërta



Lindës.

## FIORI DARDHA DHE ROBERT ALIAJ

Fiori Dardha ka pasur një përplasje të pazakontë me Robert Aliajn gjatë kohës që mernte pjesë në spektaklin "Dance with me". I gjithë sherri filloi pasi Aliaj dha përshtypjet e tij pas njëri prej performancave, të cilat nuk i pëlqyen aspak Fiorit. Kjo ka sjellë përplasjen e parë mes tyre ku Roberti iu drejtua Alketa Vejsit duke i thënë: "Mos ia u jep fjalën atyre që nisin të flasin dhe nuk dinë të pushojnë. Kjo duket se e ka nxehur më tej gazetaren dhe i është drejtuar Robertit: "Mendimi im është ndryshe nga yti, ti këtë s'pranon. Ne nuk jemi balerinë profesionistë që të thuash kjo s'më pëlqen, kjo s'më erdhi, kjo s'u përcoll". Roberti ka vazhduar më tej duke e quajtur Fiori Dardhën "gazetare mediokër". Pas kësaj gazetarja ka shpërthyer duke thënë se nuk lejon askënd të përgojë emrin e saj: "Emrin e

kam arritur me shumë punë, më ke kapur në pikën time më të fortë dhe këtë nuk ta lejoj, emrin e kam krijuar me punë në gazetari", u shpreh Fiori Dardha.

## LEDION LIÇO DHE NOIZY

Ishte Noizy ai që "sulmoi" Ledionin, pasi ky i fundit thumboi reperin gjatë prezantimit të "Top Awards" për shkak se Noizy braktisi spektaklin që të udhëtonte në Dubai. "Noizy do të duhej të ishte këtu, por ai erdhi në prova me Ferrarin e tij dhe kështu është kur shet mend me makinën e shokut" - u shpreh Ledioni në spektakël. Kjo duket se nuk i ka pëlqyer aspak Noizy -t dhe i ka kthyer përgjigje me anë të një postimi në "Instagram" ku shkruante: "Mbreti i xhunglës ecën vetë! Fuck your Awards Ledion Liço! Shko bjeri b\*\*es, por bjeri haptas! Mos mbaj të dashur sa për të mos dalë nami. Kollovar që jeton me lekët e të dashurës, bitch boy Ty s'ta bleu mami as babi, ta bleu e dashura".

Egla Xhemali

Sherret mes personazheve më të njohur shqiptarë tanimë janë bërë të zakonshme. Shpeshherë ato kanë nisur me shaka e herë të tjera me tendencë duke u bërë kështu si mjaft të njohura për publikun shqiptarë.

## TUNA DHE RUDINA MAGJISTARI

Tuna Sejdiu ka futur në sherr dy prej prezantuesve të njohur për publikun, Ermal Mamaqin dhe Rudina Magjistari. Javën që shkoi Tuna ishte e ftuar tek "Xing me Ermalin", ku foli për ndjesinë e mëmësisë si dhe për raportin me Patris Berishën. Së bashku ata folën dhe për sherrin mediatic me Robert Berishën, vellain e Patrisit. Ajo që i habititi të gjithë ishte përgjigja e këngëtares kur Ermali e pyeti nëse do shkante tek emisioni i Rudina Magjistari. "Asnjëherë në jetën time. E kam lënë hold on dhe ashtu do ta lë dhe nja 10 vite të tjera apo edhe 20 sa të jem ngjallë" - u shpreh Tuna. I menjëhershëm ka qenë dhe reagimi i prezantuesit të emisionit të pasdites në TV Klan: "Hey Tunë darling, po hakmerrësh se po bëj punën time dhe ftoj në program një këngëtarë, që për rastësi është dhe kunati yt dhe që s'e detyron njeri të thotë atë që do?! Se s'di të më ketë ndodhur gjë tjetër me ty në jetë. Sa shumë urrejtje paske në shpirt! Keq më vjen për ato që të kanë afër, sa për programin kam s'kam simpati personale, ne i ftojmë të gjithë. Këtë punë e bëjmë çdo ditë prej 10 vitesh. Kështu ti e kupton se ç'vend zë ti në këtë histori, ku prej vitesh show bizz shqiptar ka nxjerrë me dhjetëra yje, ke qejf t'i shohësh me talent, kulturë dhe klas. Hajd me shëndet! Ps Ermal e do dhe ti një?"

**NOIZY DHE ENCA**  
Këngëtarja Enca Haxhia dhe reper Noizy ishin shokë të ngushtë dhe bashkëpunorë shumë të mirë derisa realizuan këngën shumë të suksesshme "Bow Down". Pasi kënga arriti 30 milionë



klikime, Enca shprehu entuziazmin nëpërmjet një postimi në "Instagram" ku shkruante: "Jam kaq e lumtur që shoh se si një këngë që unë e kam shkruar me kaq dashuri dhe pasion sapo

ka arritur 30 milionë". Nuk ka vonuar as përgjigja e Noizyt, i cili shkruante: "30 milionë sa për të të korrigjuar Enca Haxhia. Është diçka që unë e kam krijuar nëse harrove. Dhe po je e falur.



Page". Pas kësaj miqësia mes tyre mori fund.

## ENEDA TARIFA DHE LINDA HALIMI

Në kohën kur Eneda konkurronte për në Eurovizion, Linda Halimi përmes një statusi në rrjetet sociale bëri një koment rreth këngës së saj duke e kritikuar Ene-dën për këngën baladë me të cilën konkurroi në skenën e madhe të Eurovizionit. "Njerëzit janë të lodhur nga këngët vajtuëse, dramatike, britmat! Jetojmë në një kohë ku duam ritëm, meqë na kanë mbytur hallet. Mjaft me këngë depressive, u bëmë bajat jo për gjë. Sikur na ka ngec disku në replay! Mirë, kaq kisha! Shëndet për të gjithë!" - shkroi Linda. Por Eneda nuk e harroi kritikën e hapur të këngëtares dhe gjeti pikërisht momentin e duhur për t'i kthyer asaj "borxhin e vjetër".

Mos erdhi gjë koha të të kthej statusin e vjetshëm, e dashur Linda? Bota - "portokall". (Këtu përjashtoj vetëm Klodjan Qafokun dhe Geri Xharin. Ky status nuk ka lidhje me ta). "Njerëzit janë lodhur nga këngët vajtuëse, dramatike, britmat! Jetojmë në një kohë ku duam ritëm, meqë na kanë mbytur hallet e jetës, dhe duam relaks, kënaqësi, të harrojmë hallet! Mjaft më me këngë depressive! U bëmë bajat jo për gjë...! Sikur na ka ngec disku në replay! Mirë kaq kisha. Shëndet për të gjithë", - kështu shkruante Eneda në kundërpërgjigjen ndaj





## "Në vend të Adelës", miqtë e gazetares i japin frymë nismës së saj

Një vit më parë më datë 29 tetor 2017, gazetarja Adelajda Xhamani ndërroi jetë si pasojë e një sulmi kardiak në zemër. Gjithçka ishte e papritur dhe e pabesueshme sidomos për familjarët dhe miqtë e saj të ngushtë. Këta të fundit nuk kanë reshtur me postimet e ndryshme duke kujtuar se sa ia ndjenin mungesën asaj. Dje, në përkujtimin e Adelajdës, miku i saj më i shtrenjtë, Eraldo Rexha i ka përlotur të gjithë nëpërmjet një dedikimi në "Facebook" duke kujtuar se do të marrë jetë nisma që kishin nisur të dy. "Në vend të Adelajdës" do t'i kushtohet të gjitha vajzave të provincës e që ëndërrojnë Tiranën që prej pamundësive ekonomike dhe mentalitetit nuk arrijnë kurrë të bëhen të pavarura e as të vendosin vetë për jetën e tyre. Në këtë nismë Eraldos i janë bashkuar shumë artistë, për t'i dhënë frymë projektit që Adela e donte fort. "Një vit shkoi pa ty Adela... Ti e di, na ke parë, nuk ka qenë e lehtë për asnjërin nga ne. Pa ty 'lufta' ka qenë më e vështirë, trishtimi më i fortë, gëzimi më i shkurtër... Por sidoqoftë jetuam, me ty çdo ditë, ndoshta dhe për ty, për ëndrrat e tua. Ende sot është e vështirë që të besosh se ti nuk je, çdo ditë hap whatsapp e messenger dhe mundohem të të gjej aty, dëgjoj zërin tënd, shoh fotot tona, qaj e qesh me ty, për kohën tonë, kohën e një shoqërie me ditë të paharrueshme, me lumturi, zënka, kapriçio, realizime, krenari, probleme dhe me shumë shumë dashuri. Adela, nuk e di ku je, ndoshta je krah meje në zyrë tani që po shkruaj, por edhe nëse po me shih e dëgjon nga lart, dije që më mungon shumë. Më mungon fjala jote, buzëqeshja, zgjidhja, e bërtitura, përkëdhelja, më mungon ti Adela... Shumë njerëz kur humbasin dikë të afërt, i drejtohen Zotit me pyetjen: pse e sollë në jetën time për kaq pak? Unë nuk ia bëj më Atij këtë pyetje Adela. Vendosa të mos ia bëj më, madje përkundrazi, tani e falënderoj çdo ditë që më dha mundësinë të jetoj një shoqëri të pastër, si kristali, me një vajzë si ty, që më mësoi çdo



ditë aq shumë. Lotët ende nuk janë tharë, por kur kujtoj sesa xhan më kishe dhe mendimi se je gjithmonë me mua, më ka bërë që të vazhdoj nismën që kishim në plan ta ndërmerrim bashkë... "Në vend të Adelës" është projekti që prezantohet sot, me dëshirën për të ndihmuar dhe për t'i dhënë shpresë vajzave të provincave, që ëndërrojnë Tiranën, që prej pamundësive ekonomike dhe mentalitetit, nuk arrijnë kurrë të bëhen të pavarura e as të vendosin vetë për jetën e tyre, që njësoj si ty ëndërrojnë shkollimin dhe lirinë. Më janë bashkuar shumë miq artistë në këtë projekt, Adela, ata që ti i doje fort dhe me ndihmën e tyre dhe të Zotit lart, shpresojmë të çojmë përpara këtë iniciativë që ti e kishe aq përzemër. Do takohemi bashkë pak ditë pas ditëlindjes tënde, në Tiranën që aq shumë e doje. Pusho në paqe engjëlli! Parajsa është e jotja, unë jam krenar për këtë."




## Ronela hap sherr mes reperëve shqiptarë, ja çfarë kanë bërë ata

Ronela Hajati është një nga artistet më të komentuar të momentit. Këngëtarja nuk është vetëm e preferuara e S4MM. Pas deklaratave që ka bërë për të reperi nuk është ndalur. Së fundmi, reperi ka postuar një foto të Hajatit në rrjetin social "Instagram" me mbishkrimin "Uff" shoqëruar edhe nga zemra e lule të shumtë. Ajo që bie në sy është komenti i Noizyt që shkruan: "Varrosi do të të shkatërrojë" duke nënkuptuar kështu se dhe Varrosi e ka shumë qejf Ronelën. Për këngëtarën vazhdojnë të qarkullojnë fjalë se është e lidhur me Young Zerkën, por as ajo, as këngëtarja nuk kanë konfirmuar gjë ende.



## Nicky Minaj kopjon Encën, zbuloni si reagon këngëtarja

Ajo nuk rresht së qeni në vëmendjen e të gjithëve. E kemi fjalën për Encën. Duke se këngëtarja po e kapërcen tregun kombëtar të muzikës duke u dëgjuar e njëkohësisht kopjuar nga artistët me famë botërore. Ka qenë vetë Haxhia që ka sjellë për fansat një detaj të videoklipit më të ri të Nicky Minaj, në këngën "Little Mix Woman like me". Minaj shfaqet si një pikture, në të njëjtën mënyrë që është shfaqur Enca pak kohë më parë në klipin e saj më të fundit "Kujt po i han". Bukuroshja e ka treguar këtë gjë me anë të disa postimeve në stori, pa harruar të thotë se "mendjet e njëjtë mendojnë njëjtë". Më tej, Enca ka vazhduar duke thënë se: "Kur të bëhem e famshme në të gjithë botën, ju do të thoni 'Enca ishte gjithmonë një hap para'".



## KANCELARJA LARGIMI



Kancelarja Angela Merkel

**ANGELA MERKEL**  
 "Nuk do kandidoj për kreun e CDU. Nuk do kandidoj as për kancelare. Nuk do të kërkoj post tjetër politik. Nuk do kërkoj post pasi të më përfundojë mandati. Gjatë ditëve në vijim do jap dorëheqjen si lidere e CDU. Marr përgjegjësinë për rezultatin në zgjedhjet rajonale"-tha Merkel.

### SHKURT

#### Tërmet i fuqishëm

**në Argjentinë**  
 Një tërmet i fortë ka goditur një qytet turistik në Argjentinë. Sipas Institutit Gjeologjik të SHBA-së, tërmeti ka qenë me magnitudë 6.4. Epiqendra e tij ishte në oqean, disa kilometra larg bregut të Ushuaia, Tierra del Fuego. Lëkundjet sizmike ranë në një thellësi prej 9 kilometra nën tokë. Mediat vendase nuk kanë raportuar për viktima apo për dëme materiale. Tierra del Fuego, zona ku u ndjenë lëkundjet e tërmetit, është skaji më jugor i Amerikës së Jugut.

#### Italia në alarm nga moti i keq

Italia është në alarm nga moti i keq. Reshjet e dendura të ditëve të fundit kanë shkakuar probleme nga veriu në jug. Fryrja e lumenjve ka dëmtuar dhjetëra rrugë nga rrëshqitjet e tokës. Disa zona të banuara në veri të Italisë janë krejtësisht nën pushtetin e ujit. Reshjet e dendura detyruan autoritetet në Xhenova e Venecia të japin gjatë natës alarmin e kuq, gjendenj me të lartë të gatishmërisë për katastrofat natyrore. Vala e motit të keq ka mbërritur edhe në Italinë Qendrore. Në Romë e Firence, shumë shkolla janë mbyllur pasi pritet që situata të përkëqësohet. Reshjet e dendura parashikohet të mbërrinin edhe në jug të vendit gjatë orëve në vijim.

#### Brazil, kandidati i së djathtës ekstreme fiton zgjedhjet

Ish-kapiteni i ushtrisë, Jair Bolsonaro është zgjedhur president i Brazilit pas zgjedhjeve të mbajtura ditën e diel në këtë shtet, duke premtuar ndryshim rrënjësor në shtetin e Amerikës Latine. Pavarësisht deklaratave kundërthënëse për mbështetjen e tij të hapur për torturën e kryer nga regjimi i ushtrisë së mëparshme të Brazilit dhe cilësimit të tij si racist e homofobik, Bolsonaro ka arritur të fitojë votat duke shfrytëzuar zemërimin e popullatës për korrupsionin dhe krimin. Rezultatet zyrtare e kanë shpallur atë fitues me 55.13 për qind të votave, derisa kundërshtari i tij i krahu të majtë Fernando Haddad ka fituar 44.87 për qind të votave. Bolsonaro, politikan i të djathtës ekstreme do të nisë mandatin presidencial më 1 janar. Mijëra mbështetës të tij kanë mbushur sheshet dhe rrugët e Rio de Zaneiros, duke ngritur flamuj brazilianë dhe duke nisur fishekzjarre. Shtëpia e Bardhë ka thënë se presidenti amerikan, Donald Trump ka telefonuar Bolsonaro për t'i uruar fitoren. Përndryshe, Bolsonaro, i cili konsiderohet nga disa si "Trumpi tropikal", ka treguar publikisht admirim për presidentin amerikan.

Kreu i kristian-demokratëve: Marr përgjegjësinë për rezultatin në zgjedhjet

# Largohet Merkel nga qeveria: S'do kandidoj për kancelare

Braktis postin pas 18 vitesh në krye të CDU-së

Pas 18 vitesh në krye të CDU-së, Kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel e ka konfirmuar zyrtarisht moskandidimin për kreun e partisë. Ditën e djeshme, përmes një konferencë për mediat, e para e Gjermanisë tha se nuk do të jetë më në garë për postin drejtues të partisë së saj. Krahas kësaj, Kancelarja shtoi se nuk do të kandidojë më as për postin e Kancelares së Gjermanisë. Ajo deklaroi se në ditët në vijim do të njoftojë edhe largimin e saj, ndërsa shtoi se merr përsipër të gjitha faturat e humbjes në zgjedhje. "Nuk do kandidoj për kreun e CDU. Nuk do kandidoj as për kancelare. Nuk do të kërkoj post tjetër politik. Nuk do kërkoj post pasi të më përfundojë mandati. Gjatë ditëve në vijim do jap dorëheqjen si lidere e CDU. Marr përgjegjësinë për rezultatin në zgjedhjet rajonale" tha ajo. Vendimin e mori pas rezultateve të dobëta në zgjedhjet për parlamentet rajonale në Hessen e Bavari. Ajo nuk do të rikandidojë në kongresin e dhjetorit në Hamburg. Si Kancelare do të qëndrojë deri në vitin 2021, kur t'i përfundojë mandatin për t'u larguar përfundimisht nga politika, siç njoftoi vetë në konferencën për shtyp. "Është koha për një kapitull të ri. Nuk kam lindur kancelare. Imazhi që qeveria ka krijuar nuk është i pranueshëm. Rezultatet e zgjedhjeve janë zhgënjyese dhe të hidhura. Kjo tregon se qeveria nuk arriti të bindë votuesit". Mbështetja për kristian-demokratët në zgjedhjet rajonale të Hessen-it ra me 11% nga legjislatura e kaluar. Edhe në këtë land, të gjelbrit shënuan rritje të ndjeshme, ndërsa partnerët kristian-socialë të Merkel humbën shumicën absolute në parlamentin bavarez dy javë më parë. Ndërkaq kujtojmë se arsyet kryesore e largimit të kancelares është humbja e thellë që pësoi në



### HISTORIKU I MERKEL

Më 22 nëntor 2005, Merkel mori detyrën e Kancelares së Gjermanisë pas bllokimit të zgjedhjeve që rezultoi në një koalicion të madh me SPD. Partia e saj u rizgjodh në vitin 2009 për shkak të rritjes së numrit të vendeve dhe mund të formonin një koalicion qeverisës me FDP. Në zgjedhjet e shtatorit 2013 partitë CDU / CSU doli si fituese, por formoi një koalicion të madh me SPD për shkak të dështimit të FDP-së për të marrë minimumin e 5% të votave të nevojshme për të hyrë në parlament. Angela Merkel përveç që është Kancelare e shtetit Gjerman ajo luan rol të rëndësishëm në politiken Europiane prandaj me 31 dhjetor 2014 u zgjodh personi i vitit nga revista prestigjioze NEW YORK TIMES. Angela Merkel mban lidhje të forta me shtetet fqinje por edhe me gjerë. Angela Merkel bën pjesë në grupin e liderëve më ndikim në botë. Gjatë udhëheqjes së saj shumë gjëra ndryshuan në favor të shtetit Gjerman si rritja e ekonomisë, hapja e shumë vendeve të punës, përparim në reformat shëndetësore.

zgjedhjet e fundit rajonale. Në Hessen u mbajtën të dielën zgjedhjet për parlamentin e landit, ku u dërguan

sinjale të fuqishme në drejtim të Berlinit. Humbëset më të mëdha të zgjedhjeve janë dy partitë

**VOTIMI NË HESSEN**  
 Ndër fituesit e këtyre zgjedhjeve është edhe partia populiste, Alternativa për Gjermani (AfD), e cila ka fituar 13% të votave. Në këtë mënyrë, kjo parti me qëndrime armiqësore ndaj të huajve është tjetër tani në të gjitha 16 landet e Gjermanisë. Në parlamentin e landit Hessen janë futur edhe liberalët (FDP) dhe e Majta. Liberalët fituan 7.8% ndërsa e Majta 6,0% të votave.

**VOTIMI NË BAVARI**  
 CSU, partia 'motër' e CDU-së së Angela Merkel ka pësuar një humbje të fortë në zgjedhjet për shtetin e Bavarisë në Gjermani. Të dhënat e para tregojnë se CSU ka fituar rreth 35 përqind të votave, një rënie me 12 përqind në krahasim me katër vjet më parë. Të Gjelbrit janë ngjitur duke marrë 19 përqind. Partia kryesore e të majtës, Socialdemokratët (SPD) janë katandisur me 10 përqind. Ka spekulime se kjo parti mund të dalë nga qeveria e koalicionit të madh në përprjekje për të mbijetuar si parti.

deri tani më të mëdha në vend - CDU dhe SPD. Partia kristian-demokrate (CDU) e Kancelares Angela Merkel ka fituar numrin më të madh të votave në landin Hessen. Por njëkohësisht kristian-demokratët janë edhe humbësit më të mëdhenj të këtyre zgjedhjeve, pasi CDU shënoi rezultatin më të dobët në këtë land, që nga viti 1966. Pas mbylljes së vendotimeve u tha se partia CDU ka fituar vetëm 27,4% të votave (rreth 11% më pak se në zgjedhjet e

kaluara). Humbës të mëdhenj të këtyre zgjedhjeve janë socialdemokratët (SPD), të cilët kanë shënuar rezultatin më të dobët zgjedhor në këtë land, pas Luftës së Dytë Botërore. Analistët këtë e shpjegojnë si refuzim popullor, kryesisht për mosmarëveshjet brenda koalicionit qeverisës për politikën ndaj dyndjes së refugjatëve. Mbetet për t'u parë nëse Merkel do mbijetojë në postin e kancelarit deri në vitin 2021, pasi në parti pritet të shpërthejë një luftë e ashpër.



## Indonezi, rrëzohet në det aeroplani i pasagjerëve

Ishte nisur drejt ishujve, mbytet në thellësi 30 metra avioni me 188 persona

188

### PASAGJERË

Aeroplani "Lion Air" me 188 persona në bord është rrëzuar në det menjëherë pas largimit nga kryeqyteti indonezian, Xhakarta. Fluturimi Jt 610 ishte nisur drejt ishujve Bangka Belitung kur humbi kontaktet me qendrën dhe dyshohet të ketë përfunduar nën ujë.

Një aeroplan pasagjerësh i kompanisë "Lion Air" me 188 persona në bord është rrëzuar në det menjëherë pas largimit nga kryeqyteti indonezian, Xhakarta. Fluturimi Jt 610 ishte nisur drejt ishujve Bangka Belitung kur humbi kontaktet me qendrën dhe dyshohet të ketë përfunduar nën ujë. Ekipe të emergjencës deri tani nuk kanë gjetur asnjë të mbijetuar. Aeroplani Boeing 737 ishte një lloj i ri i avionëve dhe nuk është e qartë se çfarë e ka shkakton rrëzimin e tij. "Lion Air" është kompania më e madhe e fluturimeve me kosto të ulët në Indonezi. Zëdhënësi i Agjencisë së Kërkimit

dhe Shpëtimit tha se aeroplani është rrëzuar në thellësi 30-40 metra nën ujë. Bagazhet dhe sende personale që besohet se u përkasin pasagjerëve janë gjetur në sipërfaqen e ujit, duke përfshirë karta identiteti dhe patenta. Nuk dihet nëse ka persona të mbijetuar. "Ne

shpresojmë, lutemi, por nuk mund të konfirmojmë", tha kreu i Agjencisë së Kërkimit dhe Shpëtimit. Ndërkaq një udhëtar nga Indonezia është ndoshta njeriu më me fat në ditën e djeshme, pasi humbi avionin e kompanisë "Lion Air", i cili u rrëzua në det. Sony Setiawan ishte një

nga 189 pasagjerët e planifikuar për të udhëtuar me këtë avion, i cili u nis nga Jakarta të hënën në mëngjes. Ai punonte në Ministrinë e Financës së Indonezisë, ndërsa trafiku me sa duket bëri që ai të humbte avionin, por njëkohësisht edhe të shpëtonte jetën e



tij. Pas ngjarjes, teksa familja e tij ishte e tronditur nga lajmi, ai me një telefonatë e ktheu gjithë atë hidhërim në gëzim për ta. Avioni, sipas autoriteteve kishte pasur defekte teknike, pasi kushtet e motit ishin normale. Qindra ambulanca, ushtria, zhytës dhe vullne-

tarë po punojnë për gjetjen e të gjithë trupave, ndërsa numri i viktimave ende nuk është konfirmuar i plotë. Kjo është tragjedia më e madhe në historinë e Indonezisë, ndërsa bilanci deri më tani është me të vërtetë i tmerrshëm..

## Ramadani: Serbisë po i marrin rusët qindra miliona euro nga buxheti

# Zv/ministri i FSK-së: Rusia propagandon me mashtrime kundër nesh

"Asnjëherë Kosova me institucionet nuk ka qenë kërcënim"



Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Burim Ramadani

### BURIM RAMADANI:

"Rusia po përdor propagandë krejtësisht mashtruese kundër Kosovës, ndërsa Serbisë po i merr qindra miliona euro nga buxheti duke i shitur armatim përmes aferave të mëdha të korrupsionit", tha z/ministri i FSK, Burim Ramadani.

kuvendi në 18 tetor me anën e tri projektligjeve me 96 vota pro. Gjithashtu, para disa

ditësh u përfol edhe për largimin e disa ushtarëve serbë nga radhët e ushtrisë. Por

pas daljes së fjalëve të tilla shumë shpejt u shuan nga drejtuesit e Forcës së Kosovës.

### Rusia: Ushtria e Kosovës do ta djegë gjithë Ballkanin

Ministria e Jashtme ruse ka shprehur shqetësim për vendimin e parlamentit të Kosovës për t'riktuhyer Forcat e Sigurisë së Kosovës në ushtri të plotë. Kjo ministri ka theksuar se një vendim i tillë dëmton stabilitetin e Ballkanit. "Rusia i ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen komunitetin ndërkombëtar se tendencat e tilla nuk janë në përputhje me Rezolutën 1244, e cila thotë se Kosova duhet të mbetet nën mbikëqyrjen e ndërkombehtarëve", thuhet në deklaratën e ministrisë ruse. "Askush nuk mund të japë garanci se të ashtuquajturat forca të armatosura të cilët përbëhen nga terroristë të UÇK-së nuk do të përdorin dhunë kundër popullatës serbe në Veri", thekson MPJ ruse. "Ushtria e Kosovës dëmton stabilitetin në Ballkan dhe nuk është në përputhje me të drejtat e atyre që jetojnë atje dhe e meritojnë një të ardhme të qetë dhe të sigurt", përfundon deklaratën e MPJ-së ruse. Kundër Ushtrisë së Kosovës është shprehur edhe qeveria e Serbisë, zyrtarë të së cilës kanë deklaruar se do të përdorin çdo mekanizëm për ta parandaluar themelimin e saj.

### Haradinaj: Procesi do të zgjasë 10 vjet për FSK

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj është shprehur se ndërtimi i kapaciteteve të plota të Forcave të Sigurisë së Kosovës do të zgjasë rreth 10 vjet dhe do të ndahet në tri faza. Haradinaj tha gjatë një ligjërate në një universitet në Kosovë se nuk është vetëm Kosova që do të përfitojë nga transformimi i FSK-së. "Jo vetëm Kosova, por edhe rajoni ynë do të përfitojë nga transformimi i Forcave të Sigurisë së Kosovës, pasi zhvillimi i një ushtrie të vogël multietnike dhe profesionale do të rrisë sigurinë dhe stabilitetin rajonal. Ajo shmag mundësinë e ndonjë vakumi të sigurisë në Kosovë dhe kontribuon në përafrimin e vendit tonë me vlerat euroatlantike. Kjo iniciativë do të krijojë 2500 vende të reja pune". Kryeministri Haradinaj tha se Kosova do të respektojë plotësisht mandatin e misionit të KFOR-it, ndërsa FSK-ja do të vazhdojë të mbetet një institucion partner në KFOR.

## PAPA FRANÇESKU NË GJENDJE TË RËNDË SHËNDËTËSORE

Para disa ditësh është postuar një foto e të shenjtit Papa Françesku. Kisha e Laçit ajo që ka treguar gjendjen e rëndë të të shenjtit. "Papa Françesku ka nevojë për lutjet tona. Ai ka pasur probleme shëndetësore dhe është rrëzuar dy herë brenda muajit. Papa Françesku ka vetëm një mushkëri, sepse tjetra i qe hequr si pasojë e infeksionit. Ai ka nevojë për lutjet tona më shumë se kurrë. Shkruaj Amen", - shkruhet në postim.



FOTOLAJM

## SHKRIMTARET DIKTATURA

*Së shpejti, libri më i ri "Shkrimtarët dhe artistët nën diktatin komunist", i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi*

Ekskluzive/ Korrespondenca e vitit 1974 e Haxhi Kroit me Hysni Kapon e Pirro Kondin

# Pirro Kondi mbështet Koço Danajn: Të ndalohej filmi "Gruaja më e bukur"

*Zbulohet letra e oficerit të Degës së Brendshme të Shkodrës*

Nga Dashnor Kaloçi

Brezi i shqiptarëve që kanë qenë në moshë të rritur në fillimin e viteve '70-të e kujtojnë fare mirë se si thyeshin sportelet e biletave dhe dyert e kinemave në mbarë vendin kur shfaqeshin filma të huaj si psh., ato të regjisorit të famshëm italian, Damiano Damiani, "Gruaja më e bukur" (La Miglie Piu Bella) të interpretuar nga aktorja Ornella Muti, (asokohe 14-vjeçare) në rolin e Françeska Çimarozës dhe Alesio Orano në rolin e Vito Juvare, apo "Rrëfimet e Komisarit të Policisë", ku rolin kryesor e interpretonte i madhi Franko Nero, (dhe në role të tjera, Martin Balzam e Mariku Toro), filma të cilët bënë një bujë të madhe dhe u pritën me një interes të jashtëzakonshëm nga publiku artdashës shqiptar, edhe për faktin se në qendër të filmit ishte mafia italiane e asaj kohe. Por, shkëlqimi i këtyre filmave nuk zgjati shumë dhe u venit shpejt, pasi papritur aty nga fundi i vitit 1974, si me magji, ato u zhdukën përgjithmonë nga qarkullimi për të mos u shfaqur më kurrë në kinematë shqiptare, ku bashkë me sportin, pothuaj ishin të vetmet argëtime apo më saktë "frenjgjitë" e vogla nga ku mund të shikohej pak bota e jashtë nga ai realitet i izoluar dhe mbyllja në të cilën e kishte futur vendin udhëheqja e lartë komuniste me në krye Enver Hoxhën. Edhe pse në vitet që pasuan regjisorit i famshëm italian me përmasa botërore, Damiano Damiani, do të ishte përsëri "mysafir" në Shqipërinë komuniste me filmin "La Piovra", të interpretuar në rolin kryesor nga aktori i jashtëzakonshëm Mikele Plaçido, filmat e tij "Gruaja më e bukur" dhe "Rrëfimet e komisarit të Policisë" do të mbeteshin si një kujtim i bukur i së shkuarës dhe në memorien e të rinjve të asaj kohe nuk do të fshiheshin lehtë portretet e aktorëve Ornella Muti, Alesio Orano, Franko Nero etj. Po ç'kishte ndodhur me këta filma dhe përse ata nuk u shfaqën më në kinematë shqiptare, ku vazhdohej të bëhej "rituali" me filma të huaj dhe ata italianë gjithashtu?! Të vërtetën e kësaj, pra të ndalimit të dy filmave të Damianit, që asokohe po shkëlqente me mjeshtrinë e tij në Europën e uritur për kinematë italiane, as sot e kësaj dite nuk e di njeri, pasi pothuaj të gjithë ata që morën vendimin për ndalimin e atyre filmave, tashmë prej vitesh janë ndarë nga kjo jetë. Por për fat të mirë, i vetmi dëshmitar që jeton ende është pikërisht personazhi që



Regjisorit i famshëm italian, Damiano Damiani

u bë shkas, apo më saktë ai që i "zhdukdu" ata dy filma nga qarkullimi dhe bashkë me to edhe filmin rumun "Shën Tereza dhe djajtë", (të regjisorit të famshëm, Serxhu Nikolaesku, ku rolin kryesor e interpretonte aktorja, Reka Nagi, nga pakicat e minoritetit hungarez), filmin televiziv seri-

al, prodhim çekosllavak, "Kapiteni Klos", (titulli original, "Çmimi më i lartë se jeta"), si dhe disa libra "të verdhë" si "Qeni i verdhë" (i autorit Zhorzh Simeon), etj. Ai është Koço Danaj, me origjinë nga Tepelena, personazh publik mjaft i njohur pas viteve '90-të si publicist e studiues,

por edhe i mjediseve politike si kryetar i një partie të vogël, i cili në vitin 1974 kur shërbente si oficer për kufirin (sekretar rinie), në Degën e Punëve të Brendshme të Shkodrës dhe njëkohësisht anëtar i Komitetit Qendror të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, i dërgoi një letër Haxhi Kroit, sekretarit të Enver Hoxhës, ku i kërkonte ndalimin e filmave dhe librave të sipërcituar. I diplomuar atë vit në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tiranës, njohës i disa gjuhëve të huaja dhe me një formim e bagazh kulturor për t'u pasur zili, (kryesisht për njohuritë e tij në letërsinë dhe kinematografinë botërore), por edhe i indoktrinuar jashtë mase, në letërsinë e tij dërguar në adresë të kabinetit të Enver Hoxhës, Koço Danaj ka analizuar me detaje se përse ato filma dhe libra nuk kishin vend në Shqipërinë socialiste. Pra sa më sipër, duket se nuk ishte vetëm regjimi komunist me institucionet përkatëse të propagandës që "i bënin sytë katër" për të mos "dëpërtuar ideologjia e huaj" në Shqipërinë Socialiste, por "roje vigjilente" bënin edhe individë të veçantë, si në rastin në fjalë, që nuk e kishin atë gjë detyrë funksionale. Dhe si rezultat, duket se letra e oficerit të ri, Danaj, asokohe "ka zënë vend", pasi filmat dhe librat që ai "sugjeronte" të ndaloheshin, jo vetëm u hoqën nga qarkullimi, por disa institucione që i kishin ato në varësi, si Kinostudio "Shqipëria e re", "Shhtëpia Botuese "Naim Frashëri" apo Radio-Televizioni Shqiptar, patën mjaft probleme sepse i kishin lejuar apo hedhur ato në qarkullim. Jo vetëm kaq, por letra e oficerit të ri të Kufirit ishte e "kopsitur" aq "hollë", sa vuri në siklet edhe vetë udhëheqjen e lartë të PPSH-së së asaj kohe, si Hysni Kapon, Piro Kondin etj., sa që nuk dinin se si, ku dhe çfarë përgjigje t'i jepnin atij si autor i saj?! Interesant është fakti se përse ajo letër nga kabineti i Enver Hoxhës nuk i është dërguar për "shqyrtim" Ramiz Alisë që mbulonte artin, kulturën dhe propagandën, por Hysni Kapon, i cili mbulonte organet e "Diktaturës së Proletariatit"! Lidhur me këto e të tjera, na njeherë në fjalë që publikohet e plotë dhe për herë të parë në faqet e këtij libri e gjithashtu ekskluzivisht për "Gazeta Shqiptare".

(vijon nga numri i kaluar)  
**LETRA E KOÇO DANAJT PËR SEKRETARIN ENVERIT, HAXHI KROI**

"Qeni i verdhë" është një roman i Zhorzh Simeonit, i njohur në botën



borgjeze si autor romanësh policorë, por që prek edhe tema sociale. Lidhur me figurën e këtij autori, qëndrimi i autorit të parathënies së romanit bie në kundërshtim me qëndrimin që mban një autor tjetër i huaj. Në librin "Shturje dhe degjenerim në Jugosllavinë titiste", të Dimitri Jojçit, thuhet se shprehje e degjenerimit të kulturës dhe letërsisë jugosllave është midis të tjerash edhe përkthimi i veprave të shkrimtarit bulevardesk, Zhorzh Simeon. Por të lexosh romanin tek filmi "Rrëfimet e komisarit të Policisë", është kretje false. Këto figura "shërbëtorësh të borgjezisë", mund të ekzistojnë vetëm në imagjinatën e autorëve, po në asnjë mënyrë në realitetin e asaj shoqërie. Ky komisar Megre dhe Bonavia, sipas autorëve, na bëkan shumë të mira, i pari fut në burg tre afaristë borgjezë për të shpëtuar një marinar të varfër, kurse i dyti arrin dhe vret padronin e tij, manjatin e fuqishëm Lomuno.

Sa e paqenë është figura e komisarit Megre, me anë të cilit Simeoni kërkon të na mbushë mendjen për karakterin "demokratik" të rendit borgjez, na e tregon një film tjetër i huaj dhe pikërisht filmi "Çështja Sabiel", në të cilën për të mbuluar vrasjet e Sabielit, mekanizmat e ndryshme shtetërore vunë në shërbim tyre çdo gjë dhe, kur u mundua një komisar policie të zbulonte vrasjen, ai u zhduk menjëherë. Dhe kjo është e natyrshme: diktatura borgjeze nuk mund të lërë në organet e saj njerëz që s'i shërbejnë me fanatizëm. Po kështu, edhe filmi "Rrëfimet e komisarit të policisë", që kur mbaron të duket sikur thotë: "Dëgjoni njerëz, mos ngrihi kokën dhe mos protestoni kundër gjendjes suaj të vajtshme, sepse mafia të bën të zezën". Për të larë borxhin, regjisorit fut në skenë edhe një punëtor që gjoja proteston dhe në fund gjen vdekjen, por që në fakt s'ka asgjë të përbashkët me proletariatin, është një surrogatë i





...dhe shpreh shqetësimin lidhur me disa nga filmat me përmbajtje të huaj që shfaqen dhe se disa botime që janë bërë e bëhen tek ne. Koço Dana, në frymën e materialeve të Partisë dhe të fjalimeve të shokut Enver, analizon drejt se ç'është përmbajtjen e disa filmave dhe librave të përkthyer që ka parë e lexuar.

Autori i kësaj letre Koço Dana, që dërgon mua si sekretar i shokut Enver është njëri nga Tepelena nga familje e mirë. Është anëtar i Komitetit Qendror të Rinisë që ka kryer vitin kaluar Fakultetin e filozofisë. Tani është oficer i organet e punëve të brendshme në Shkodër ku punon me rininë e forcave të kufirit.

Këto ishin, shoku Haxhi, problemet që unë mendova t'i shtroj në këtë letër dhe jam munduar t'i shikoj me syrin e Partisë dhe të marksizëm-leninizmit, por nuk di nëse kam të drejtë apo jo për këto çështje. Prandaj do t'ju lutesha a ka mundësi të më sqarojë partia për këto problem, jam unë me këto mendime që kam për veprat e lartpërmendura plotësisht në vijën e Partisë apo mendimet e mia janë të gabuara.

**Koço Dana  
Dega e Punëve të Brendshme  
Shkodër**

**SHËNIMI I HYSNI KAPO PËR PIRO KONDIN LIDHUR ME LETRËN**

Shoku Piro  
E shihni këtë letër me kujdes, bisedoni me shokët, çfarë konkluzione nxirni? Çfarë mendime keni? Nëse vërejtjet e këtij oficeri të ri janë të drejta, të paktën duhet t'i bëjmë përgjigje dhe të mbahen parasysh. Më raportoni

30.XII.1974 Hysni Kapo

**SHËNIMI I SEKRETARIT TË ENVERIT, HAXHI KROI, PËR LETRËN**

Autori i kësaj letre, Koço Dana, që ma dërgon mua si sekretar i shokut Enver është njëri nga Tepelena nga familje e mirë. Është anëtar i Komitetit Qendror të Rinisë, që ka kryer vitin e kaluar Fakultetin e Filozofisë. Tani është oficer në Organet e Punëve të Brendshme në Shkodër, ku punon me rininë e forcave të kufirit.

Ai shpreh shqetësimin lidhur me disa nga filmat me përmbajtje të huaj, që shfaqen dhe me disa botime që janë bërë e bëhen tek ne. Koço Dana, në frymën e materialeve të Partisë dhe të fjalimeve të shokut Enver, analizon drejt me duket përmbajtjen e disa filmave dhe librave të përkthyer që më parë ka lexuar. Mendoj që letra t'i dërgohet Komitetit të Partisë në Shkodër për ta sqaruar të interesuarin për shqetësimet e tij.

27.XII.1974 Haxhi Kroi

**LETRA E PIRO KONDIT PËR HYSNI KAPON LIDHUR ME LETRËN**

Shoku Hysni  
Problemet që ngre në letrën e vet Koço Dana për disa filma dhe vepra letrare janë të drejta. Veprat u ripanë e u studuan dhe njëherë prandaj dhe përgjigjen e vonuam. Kinostudio dhe Televizioni e kanë rishikuar në tërësi tërë fondin e filmit. Veprat për të cilat bëhet fjalë në letër u shikuan dhe veçanërisht. Lidhur me filmat, për të cilat bëhet fjalë, janë marrë masa: "Shën Tereza dhe djajtë", "Gruaja më e bukur" si dhe filmi televiziv çek, për të cilin bëhet fjalë janë hequr nga qarkullimi. Filmi "Rrëfimet e komisarit të policisë" ka disa kufizime ideore, por ka edhe vlera demaskuese. Shokët e Kinostudios po i bëjnë disa shkurtime dhe do ta shqetësojnë me një shënim kritik, pastaj mendojnë ta hedhin prapë në qarkullim. Libri "Komisari i Policisë" ka gjithashtu gabime ideore dhe nuk duhet përkthyer. Për të njoftuar autorin e letrës, meqenëse ai punon në Shkodër, lajmëruam Komitetin e Partisë të atij rrethi ta thërrasë atë, ta falënderojë për interesimin e t'i tregojë se vërejtjet që bën janë të drejta e u morën masa. Atë e thirrri shoku Sotir Kamberi.

Tiranë, më 14.4.1975 Piro Kondi

tyre. Skenat makabre dhe ato të ngjeshme, për mendimin tim, autorët e filmit i kanë vënë jo pa qëllim, ata kanë dashur të tregojnë forcën dhe fuqinë që marrin forcat më të zeza të reaksionit italian, në krye të të cilave qëndron banditi Almirante. Këto ishin disa nga prodhimet e huaja që i janë dhënë spektrotorit tonë dhe për arsytet e mësipërme sjellim më shumë dëm se sa dobi. Këtë gjë e them duke u nisur nga i gjithë vlerësimi që i bëni Partia dhe shoku Enver armiqve tanë dhe veçanërisht nga materialet mbi rrethimin e egër imperialisto-revizionist. Duke folur për këtë rrethim të egër dhe real shoku Enver tregon qëllimin dhe rrezikshmërinë e tij si dhe detrajt që u dalin njerëzve tanë për ta përballuar atë. Së pari, shoku Enver thekson se: "Partia me luftën kundër ndikimeve borgjezo-revizioniste e ka parë...". Gjithmonë si një ndër kushtet themelore për zhvillimin e pandërprerë të revolucionit dhe ndërtimit të socializmit... Gjithashtu, si një kusht i domosdoshëm për vetë ekzistencën dhe zhvillimin e saj si parti

marksiste-leniniste". Së dyti, shoku Enver godet rëndë mendimet dhe konceptet se armiqet s'kanë ç'të na bëjnë, se ne jemi imunizuar nga shfaqjet e huaja etj. "...Në kushtet aktuale të rrethimit dhe të një presioni të gjithanshëm imperialisto-revizionist jemi shumë larg asaj që të mendojmë se jemi të imunizuar nga rrezikjet". Së treti, shoku Enver jep edhe karakteristikat e diversionit të sotëm ideologjik, veçorinë e tij kryesore. "Karakteristikat e diversionit të sotëm ideologjik të borgjezisë dhe revizionizmit kundër socializmit është bashkimi në një front të vetëm i rrymave themelore kundërrevolucionare, që nga ideologjia e mirëfillta borgjeze me karakter të hapët antikomunist e deri tek oportunitizmi i vjetër tradicional, që nga revizionistët modern e deri tek rrymat e sotme oportuniste të ashtuquajtura të majta...". Së katërti, shoku Enver tregon dhe qëllimin e vërtetë të artit dhe kulturës borgjezo revizioniste, duke treguar falsitetin e tyre mbi preten-

Shoku Hysni,  
Problemet që ngre në letrën e vet Koço Dana, për disa nga filmat me përmbajtje të huaj që shfaqen dhe se disa botime që janë bërë e bëhen tek ne. Koço Dana, në frymën e materialeve të Partisë dhe të fjalimeve të shokut Enver, analizon drejt se ç'është përmbajtjen e disa filmave dhe librave të përkthyer që më parë ka lexuar. Mendoj që letra t'i dërgohet Komitetit të Partisë në Shkodër për ta sqaruar të interesuarin për shqetësimet e tij.

P. Piro,  
E shpreh shqetësimin lidhur me disa nga filmat me përmbajtje të huaj që shfaqen dhe se disa botime që janë bërë e bëhen tek ne. Koço Dana, në frymën e materialeve të Partisë dhe të fjalimeve të shokut Enver, analizon drejt se ç'është përmbajtjen e disa filmave dhe librave të përkthyer që më parë ka lexuar. Mendoj që letra t'i dërgohet Komitetit të Partisë në Shkodër për ta sqaruar të interesuarin për shqetësimet e tij.

dimet për të mosnjohur "paragjykime sociale dhe angazhimin ideologjik". Ky qëllim është "... ta kthejë njeriun e thjeshtë në një konsumator pasiv të ideve të helmatacuna borgjeze dhe t'ia bëjë këtë konsum një nevojë e zakon. Nga kjo kulturë ne jo vetëm njohim masat dhe rininë, por atë ne duhet ta flakim me përbuzje dhe ta luftojmë me vendosmëri". Së pesti, shoku Enver tregon dhe karakteristikat delikat të vlerësimit të kulturës dhe të artit të huaj, rrezikun e rënies në ksenofobi apo ksenomanë. "... E tërë kjo - thekson shoku Enver - kërkon një punë të kujdesshme nga ana jonë të pjekur dhe të shkallëzuar, kërkon mënjanimin e qëndrimeve ekstreme që kanë për bazë ksenomaninë ose ksenofobinë, liberalizmin ose sektarizmin, mungesën e qëndrimit kritik ose të qenit brenda...". Së gjashtë, shoku Enver jep edhe porosinë e vlefshme për t'i luftuar shfaqjet e huaja që në embrion. Ai thekson se, "...shoqërinë tonë të shëndoshë e shqetësojnë dhe duhet ta shqetësojnë gjithnjë fenomene të tilla edhe sikur këto të jenë fare të pakta, për arsye se ne luftojmë që të ruajmë pastër e të shëndoshë ndërgjegjen dhe figurën morale të çdo njeriu, për të ruajtur të pastër gjithë shoqërinë tonë socialiste...". Së shtati, shoku Enver jep dhe përçaktimin klasik të mënyrës borgjezo-revizioniste të jetesës, shfaqjet më tipike të cilit janë individualizmi dhe egoizmi i shfrenuar, boshllëku dhe vaniteti, rendja pas luksit dhe plotësimi të gjithfarë tekash, shturja dhe gjenerimi, parazitizmi dhe kriminaliteti që janë bërë plotësisht pasqerueshme morale dhe sociale të shoqërisë së sotme kapitalisto-revizioniste".

Duke u nisur nga këto mësimet e çmuara të shokut Enver, mendoj se Kinostudio dhe Televizioni, kur nxjerrin filma të huaj në qarkullim, harrojnë në disa raste porosinë e udhëheqësit tonë që thotë se, "...duhet të kemi parasysh kurdoherë dhe

në çdo hap që bëjmë nëse kjo u shërben dhe sa u shërben formimit dhe edukimit të njerëzve tanë, ndreq apo prish atë që Partia po e ndërton çdo ditë, çdo orë...". Po kështu, shokët e Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri" me disa botime liberale të huaja harrojnë përsëri porosinë e shokut Enver se çfarë duhet të përkthejmë nga letërsia botërore. "Ne duhet të zgjedhim - thotë shoku Enver - ata autorë dhe ato libra që janë nga më përparimtarët, nga më revolucionarët dhe të momenteve revolucionare". Por, duke harruar këtë porosi, ata në disa raste i japin prioritet anës materiale, realizimit të planit, duke mos parë dëmin e tyre në fushën ideologjike. Mendimi im është se shfaqja e disa filmave dhe përkthimi i disa librave të huaja më shumë i shërbejnë armikut se sa neve, me këto ndodh ashtu si thotë partia jonë që shkallëmojmë natën atë që ndërtojmë ditën. Unë mund të mos kem plotësisht të drejtë në vlerësimin e këtyre prodhimeve të huaja, helmi atje mund të jetë fare i pakët, megjithatë partia na mëson se duhet të shqetësohemi dhe për më të voglat për të ruajtur të pastër shoqërinë tonë socialiste. Atëherë kur ne kemi të qartë porosi të tilla, përse të marrim filmin, pavarësisht nga idetë që ka dhe t'ia japim si ushqim shpirtëror spektrotorit? A i prishim kështu punë Partisë, luftës që bën ajo për të përballuar rrethimin imperialisto-revizionist? Për mendimin tim, i prishim. Partia neve na ka bërë të qartë se periudha e rrethimit është një periudhë e jashtëzakonshme. Duke u nisur nga ky mësim i Partisë, del konkluzioni se edhe kërkesat e njerëzve ndaj vetes dhe punës duhet të jenë të jashtëzakonshme, vigjilanca për të mos depërtuar asnjë "pikulë" helmi të jetë po ashtu e jashtëzakonshme. Këtë mësim të çmuar të Partisë, institucionet e përmendura më lart nganjëherë e nënvlerësojnë ose nuk e kanë kuptuar siç duhet.



Koço Dana

## KONFERENCA

Fatmira Nikolli

# TË MOHUAR NGA REGJIMI

## Gratë e lirisë, një garuzhde lëng dhe xhipsi me operativin

Nis Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me 36 studiues, Sula: Një agjendë kombëtare për kërkimin shkencor e përkujtimin



Kampi ishte një copë tokë rrethuar me tela me gjemba me skela mbi të cilat policët me mitralozë ruanin, të gatshëm për të vrrarë goftë edhe pranë rrethimit. Si strehë ishin baraka veshur anash me rrogözë e sipër mbuluar me letër katrama. Përgatiteshin për punë pa u shuar mirë yjet e duke dalë nga kampi, pasi numëroheshim si bagëtia nga oficeri i rojes, niseshin, të shoqëruar anash rreshtit nga policë të shumtë të armatosur për në vendin e punës, i cili mund të ishte disa kilometra larg. Atje të rrethuar nga një gardh policësh, si skillevër faraonësh, punonin me gjithë fuqinë e trupit gjatë orarit të punës nën diellin përvëlues ose në acarin e dimrit. Si përfundonte ky orar, ktheheshin në kamp duke shpejtuar e vrapuar nën kërcënimet e goditjeve të policëve. E në këtë turr e ngutje disa rrëzoheshin, të tjerë vinin nga pas, kalonin mbi të rrëzuarit, që duke u munduar të ngriheshin, kapeshin pas rrobave të leckosura të shokut. Në hyrje të kampit, si në strungë, prapë numëroheshin që rojet të siguroheshin nëse ishin po aq sa kishin dalë. Pasi hanin të babëzitur garuzhden me lëng ku mund të notonte ndonjë fije makarone ose kokërr orizi, ashtu tërë baltë e pluhur, të lodhur për vdekje shtriheshin në dyshemenë shtrart për të rimarrë forcat, të cilat nga dita në ditë, sa vinin e shtroheshin. Në mëngjesin e ditës tjetër ndiheshin po aq të lodhur sa në natën e shkuar. Dikur kampet e rrethimit me tela me gjemba zëvendësohen me sektorë të fermave që nuk kishin të sossur. Aty vendoseshin qindra e mijëra të internuar nga të gjitha anët e Shqipërisë. Nuk janë të pakta rastet kur xhipsi me targën 01 shkonte në sektorë dhe për të arrestuar ndonjë, ndaj xhipsi me operativin me automatik në krah sillej nëpër sektor me orë të tëra për t'u kallur frikën të internuarve. Ata pyesnin njëri-tjetrin, se kush e kish radhën atë ditë. Valjeta Kafallin i përshkruan kampet e internimit gjatë komunizmit në detaje, gjatë një studimi mbi jetën e p. rditshme. Rrëfen se trajtimi ishte mizor. Të burgosurit, si pasojë e dënimit me punë të detyrueshme punonin në kampe pune për të tharë kënetat, për të hapur kanale, në miniera dhe kudo ku vendoste Ministria e Brendshme, dikasteri tipik i dhunës.

Ajo është vetëm një nga 36 studiues që merr pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare "T. mohuar nga regjimi": burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri 1945-1990. Konferenca që organizohet nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studiave Albanologjike, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe Institutin për Integritimin e ish-të Përdjekurve Politike u çel mbremë nga Genta Sula, kryetare e Autoritetit për Informim mbi Dosjet e Sigurimit të Shtetit. "Studiuesit do e ndihmojnë sho-

qërinë tonë t'u përgjigjet pyetjeve pse dhe si ndodhi, që në një kohë aspak të largët, shqiptarët u vunë kundër njëri-tjetrit. Protagonistët ende jetojnë, faktet akoma nuk kanë dalë të gjitha në dritë; kujtimet dhe ditarët janë ende pa mbledhur e pa botuar; arkivat, përveçse janë masive, janë ende të pashfrytëzueshme plotësisht", tha Sula, duke pyetur nëse është normale që ende sot të mbetet i pacenuar nga hapja e arkivave sekrete, por edhe personat të mos riviktimizohen përmes publikimit të thashethemeve dashakeqe që ushqenin urrejtjen klasore. Po i shërbejmë dokumentet e publikut në zyrat tona, në formë të digitalizuar. Po i publikojmë rast pas rasti, në formë inventarësh, të zbardhura në libër, ose 'online' në uebfaqe, apo në media sociale. Shoqëria me studime të studiuesve, e deri në ekspozita, apo kemi konceptuar edhe muzealizim", nënvizoi Genta Sula. Ajo theksoi se AIDSSH ka marrë angazhim që të organizojë sa më mirë bashkëpunimin me viktimat dhe familjet e tyre. "Qëllimi është që të dëgjohet edhe zëri i viktimave. Fakti është që në dosjet e Sigurimit mungon zëri i viktimave. Për ju të gjithë kjo është e qartë se pse. Këto dosje organizoheshin për të shtypur e kontrolluar armiq të Partisë. Institucioni i mbrojtjes përmes avokatit mbrojtës nuk ekzistoi. Shpesh procedurat kanë qenë jashtëligjore. Mjafton të përmend rastin e të internuarve në kampet me tela me gjemba deri në 1954, ku me qëllim të qartë nuk hartoheshin as lista, por kishte vetëm numra", shtoi Sula, duke bërë me dije se përmes bashkëpunimeve me kolegë dhe hulumtues, do të ngrihet një agjendë kombëtare për kërkimin shkencor dhe përkujtimin, përf-

mbetet i pacenuar nga hapja e arkivave sekrete, por edhe personat të mos riviktimizohen përmes publikimit të thashethemeve dashakeqe që ushqenin urrejtjen klasore. Po i shërbejmë dokumentet e publikut në zyrat tona, në formë të digitalizuar. Po i publikojmë rast pas rasti, në formë inventarësh, të zbardhura në libër, ose 'online' në uebfaqe, apo në media sociale. Shoqëria me studime të studiuesve, e deri në ekspozita, apo kemi konceptuar edhe muzealizim", nënvizoi Genta Sula. Ajo theksoi se AIDSSH ka marrë angazhim që të organizojë sa më mirë bashkëpunimin me viktimat dhe familjet e tyre. "Qëllimi është që të dëgjohet edhe zëri i viktimave. Fakti është që në dosjet e Sigurimit mungon zëri i viktimave. Për ju të gjithë kjo është e qartë se pse. Këto dosje organizoheshin për të shtypur e kontrolluar armiq të Partisë. Institucioni i mbrojtjes përmes avokatit mbrojtës nuk ekzistoi. Shpesh procedurat kanë qenë jashtëligjore. Mjafton të përmend rastin e të internuarve në kampet me tela me gjemba deri në 1954, ku me qëllim të qartë nuk hartoheshin as lista, por kishte vetëm numra", shtoi Sula, duke bërë me dije se përmes bashkëpunimeve me kolegë dhe hulumtues, do të ngrihet një agjendë kombëtare për kërkimin shkencor dhe përkujtimin, përf-

**Kryetarja e Autoritetit: Në kampe nuk hartoheshin as lista, por kishte vetëm numra**

shirë këtu edhe objektet e ndërgegjes, për të cilat është bërë ende shumë pak.

Konferenca organizohet në kuadër të projektit "Përkujtojmë për të shëruar dhe parandaluar", dhe mbështetet nga PNUD në Shqipëri dhe Qeveria e Italisë, Fondacioni Konrad-Adenauer (KAS) dhe Rrjeti European i Kujtesës dhe Solidaritetit (ENRS). Duket se opinioni publik tregon një lloj refuzimi për t'u p. rfshtirë n, debate mbi dhunën shumëplanëshe që ushtronte regjimi ndaj kundërshtarëve të tij politikë dhe familjeve të tyre, mbi sistemin e burgjeve dhe at, t, internim/dëbimeve, mbi vuajtjet e njerëzve në këto burgje dhe kampe dhe keqtraj-

leve dhe temperamente të hekurta, pavarësisht vuajtjeve apo përdhosjes së dinjitetit që i bëhej nga pushteti i asaj periudhe. Analizimi dhe interpretimi na prezanton dhe disa karakteristika, përshkrimi i të cilave goftë me fjalë me kuptim të drejtpërdrejt apo të figurshëm (me anë të epitetëve, metaforave etj.), nuk do të mjaftonte për të ndërtuar një kuadër të plotë të figurës së tyre, duke u ndalur sidomos në vlerësimin e vetëdijes intelektuale, integritetin, si dhe frymën idealiste që i karakterizonte. Rezulton se gratë e marra në studim hodhën themelet e para dhe tentuan krijimin e një shoqërie demokratike dhe të lirë.

### KAMPET PA LIGJ

Celo Hoxha, nëndrejtor i Institutit për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, në studimin e tij vë në dukje izolimin e famil-



timet e shumta që ata vuajtën në to dhe duke parë që mungojnë studime serioze mbi punën e detyruar dhe sistemin e internim-dëbimeve, që nuk janë ndërtuar ende vende të kujtesës mbi regjimin komunist konferenca synon të hapë siparin për të tjerë në vazhdim mbi trajtimin shkencor të periudhës së regjimit. Temat që trajtohen në të janë gjithëpërfshirëse e mes tyre, përmendim disa.

### GRATË PËR LIRINË

Identitete dhe profile i grave të dënuara politike në periudhën komuniste (1946-1979), një studim nga Fiona Todhri e Eris Dhamo, sjell fakte, dëshmi dhe përvoja të të gjitha grave e burrave që vuajtën dhe u privuan pa të drejtë jo vetëm nga liria, por dhe nga ëndrra e tyre për një vend më të mirë dhe të lirë. Referuar analizës së proces-verbaleve gjyqësore që janë mbajtur për këto gra të dënuara politike, letërkëmbimeve, mbrojtjes, deponimeve, si dhe akuzave të bëra gjatë gjyqimit ose/ dhe mungesës së gjyqimit, dorëshkrimeve, punimeve dhe mbrojtjes së disertacioneve, rezulton shprehja e forcës së mendimit, qëndresës, idea-

**GRATË**  
"Nuk do të mjaftonte për të ndërtuar një kuadër të plotë të figurës së tyre, duke u ndalur sidomos në vlerësimin e vetëdijes intelektuale, integritetin, si dhe frymën idealiste që i karakterizonte. Rezulton se gratë e marra në studim hodhën themelet e para dhe tentuan krijimin e një shoqërie demokratike dhe të lirë".

jarëve të të dënuarve a të arratisurve në vende të caktuara, nën mbikëqyrjen e ushtrisë ose policisë. Por, ai vëren se në disa dokumente që quhenin kampe internim, ndër- sa personat e izoluar konsideroheshin të internuar, në vitet e para





Opinion *i* Ditës

# E vërteta e thjeshtë e vrasjes së Kostandin Kaçifas

Nga Dritan Hila

(vijon nga faqja 1)

... por jo llojin dhe përmasat e aksionit të tij. Në momentin që ai ka hyrë në veprim në tokën shqiptare, paralelisht me njoftimet nga terreni, policia shqiptare ka marrë edhe kërkesën e homologëve grekë që të bllokohet futjen e tij në territorin grek. Nuk është hera e parë që policia shqiptare paguan koston e vonesave të palës greke.

Gjithsesi pas kësaj policia shqiptare nuk ka pasur nevojë për shtytje pasi Kaçifas ka derdhur plumba mbi ata dhe gjurmët e tyre janë mbi automjete apo në pozicionet e trupave RENEA. Gjithë sa thuhet më vonë për rrugët që mund të ndiqnin trupat shqiptare për neutralizimin e agresorit, janë hamendësime profanësh. RENEA është një trupë e parametrave perëndimorë e trajnuar nga specialistë perëndimorë dhe zbaton standardet e tyre.

Ajo që ka qenë një operacion i thjeshtë policor, po rrezikon të shndërrohet në një tallava tipike ballkanike. Gjithçka do ishte mbyllur në kuadrin e një operacioni neutralizimi të elementit kriminal sikur bjerrakohësit e



rrjetit mos fillonin të shtënat nga frëngjitë e rrjeteve sociale dhe pastaj e gjitha të kalërohej nga portalet për të përfunduar në gojën e politikanëve të dorës së dytë që duan të rrisin kredibilitet.

Aktualisht marrëdhëniet mes dy vendeve nuk janë në fazën rozë, por as nuk duhen lejuar të përfundojnë në banalitete. Vetë Tsiprasi nuk është shprehur mbi ngjarjen.

Rama mund ta kursente komentin në 'Facebook'. E mira është që edhe politikanët e skalionit të dytë të gjejnë kauza të tjera.

dhe krijojnë psikozën sikur Greqia ishte rreshtuar për luftë. Nuk mungonin as debilët nga krahu tjetër të cilët premonin marrjen e gjakut apo përdorimin e aviacionit për të bombarduar Shqipërinë. Ekstremet e budallallëkut bashkohen. Dhe pas kësaj nuk munguan as politikanët e dorës së dytë dhe të tretë që kanë shkuar në vendngjarje që të gjejnë një kauzë.

Aktualisht marrëdhëniet mes dy vendeve nuk janë në fazën rozë, por as nuk duhen lejuar të përfundojnë në banalitete. Vetë Tsiprasi nuk është shprehur mbi ngjarjen. Rama mund ta kursente komentin në 'Facebook'. E mira është që edhe politikanët e skalionit të dytë të gjejnë kauza të tjera. Sa ndodhi në Bularat ishte një operacion i thjeshtë policor i menaxhuar me sukses nga policia shqiptare. Të gjithë fitojnë nga bashkëpunimi në fushën e krimit dhe marrëdhëniet mes dy popujve humbasin nga përdorimi i krimit për qëllime politike. Kostandin Kaçifas për njëqind arsye që mund të jenë shëndetësore apo sociale, kishte zgjedhur ta shprehte frustrimin e tij në një mënyrë që e pagot shtrenjtë. Për fat numri i viktimave u mbyll tek ai. Dhe aty duhet të mbyllet edhe kjo histori.

Gjatë këtyre momenteve nuk kanë munguar nxitjet e idiotëve të rrjetit, të cilët nuk shquhen për diversitet. Nga pala shqiptare kryesonte një farë Arben Lllalla. Ky kishte marrë një foto trupash komando të s'dihet kujt shteti dhe e paraqiste si mbështetëse të Kostandinit që prisnin në kufirin greko-shqiptar që ta tërhiqnin. Askush nuk mori se nga e kishte burimin ky mitoman dhe ku i kishte gjetur pamjet e kufirit grek në Elbasanin ku banon. Gjithë portalet botonin këtë foto

Te gjitha te rejat nga jeta ipave

GAZETA SHQIPTARE

GAZETA SHQIPTARE



Dje në "Deutsche Welle"

# BE-ja kundër mbetjeve plastike

Nga Barbara Wesel

(vijon nga faqja 1)

... në nivel ndërkombëtar. Edhe raportimet e shumë pushuesve nga plazhet e mbytura me kilometra të tëra prej mbeturinave plastike në mbarë botën i kanë nxitur politikanët dhe qytetarët që t'i thërrasin arsyesh, se ka ardhur koha për të vepruar. Të martën, një studiues austriak shokoi me zbulimin e tij, që partikujt plastikë dëshmojnë edhe në zorrët e njeriut. Unanimiteti i Parlamentit Europian është përtej kufijve partiakë dhe një propozim i Komisionit të BE-së për kufizimin e mbeturinave plastike në Europë u pranua me shumicë dërmuese.

## PËR ÇFARË BËHET FJALË?

BE-ja prodhon çdo vit 26 milionë tonë mbeturina plastike, kjo i përgjigjet një të katërtës së volumit mbarëbotëror. Vetëm 30% e kësaj mase arrin të riciklohet. Kina ndërkohë e ka ndaluar importin e mbeturinave plastike nga Europa. Tajlanda do të pasojë me ndalimin e këtij importi pas dy vjetësh. BE-ja duhet të zhvillojë strategji të reja, për ta zgjidhur problemin aty, ku ai e ka burimin.

## LUFTË PLASTIKËS QË PËRDORET VETËM NJË HERË

Gjatë dy viteve të ardhshme Komisioni i BE-së do të ndalojë enët plastike. E njëjta gjë vlen edhe për pipat e stekat për mbajtjen e tollombazeve. Gjysma e mbeturinave plastike në Europë përbëhet prej të tilla mbetjesh.

Gjithashtu, ambalazhimet plastike në tregun europian deri në vitin 2030 do të jenë të ripërdorshme ose të riciklueshme me efikasitet në kosto. Në këtë drejtim kritikët si ekologjistët kërkojnë që afati i tranzicionit të shkurtrohet deri në vitin 2025, shmangia dhe ripërdorimi i ambalazheve plastike duhet të ketë prioritet kundrejt riciklimit.

E më e rëndësishmja mikroplastika, që përdoret në produktet kozmetike si pastë dhëmbësh apo kremra, sa të jetë e mundur duhet të kufizohet. Kjo vlen edhe për uniformat e punës që përmbajnë mikroplastikuj dhe shiritat ndriçues apo elementë të ngjashëm, si dhe për të ashtuquajturat "plastikë oxo-biologjikisht e shpërbëshme". Ato shpërbëhen në komponentë gjithnjë e më të vegjël dhe në fund në mikropartikuj, që gjithashtu depërtojnë në rrjetin e ushqimeve për njeriun dhe për kafshët.

Kritikët tërheqin vëmendjen në këtë drejtim, se duhet vepruar më shpejt dhe më ashpër. Suedia psh., e ka ndaluar mikroplastikën në produktet kozmetike qysh tani në vitin 2018. Ndalimi është i mundur të realizohet shpejt e pa probleme, deklarohet ekologjistët në Parla-



mentin Europian. Probleme mund të krijohen edhe nga plastika, që konsiderohet si biologjikisht e shpërbëshme dhe e kompostueshme. Komisioni propozon etiketimin dhe një asgjësim më të mirë të mbetjeve të këtij lloji. Në të kundërt, mbrojtësit e mjedisit paralajmërojnë nga shtimi i vazhdueshëm i partikujve plastikë edhe në tokat bujqësore. Përveç kësaj, plastika kompostohet me shumë vështirësi.

## SHISHET PLASTIKE DUHET PËRDOREN SHUMË HERË

Të gjitha shishet plastike në BE brenda shtatë viteve të ardhshme duhet të kalojnë në sistemin e ripërdorimit. Për këtë do të ven-

dosen sistemet e pagesës për shishen që kthehet. Pas disa vitesh aplikim, ky sistem gjerman e rendit Gjermaninë në vendin e nderit për mbrojtjen e mjedisit. Propozohet gjithashtu që në dekadën e ardhshme gradualisht shihet të prodhohen nga material i riciklueshëm.

Masa të tjera janë udhëzimet për asgjësimin e përshatshëm si dhe etiketimin e produkteve me përmbajtje plastike në facoletat kozmetike, tamponët apo tollombazet.

Konsumatorët dhe disa grupe të caktuara profesionale, si peshkatarët, duhet të informohen më mirë për pasojat e flakjes pa kriter të mbeturinave plastike. Rrjetat

gigande të peshkimit që notojnë nëpër dete paraqesin një rrezik të madh për kafshët e detit. Po ashtu, prodhuesit duhet të involvohen më shumë si në kuadër të përgjegjësisë për kostot e mbetjeve që ato prodhojnë ashtu edhe në fushatat sensibilizuese për pastrimin dhe mbrojtjen e mjedisit.

## SI DO TË ECET MË TEJ?

Projektligji nga Parlamenti Europian do t'i kalojë Këshillit të Ministrave përgjegjës. Atje ekziston rreziku që të përfshihen interesat kombëtare në legjislacion dhe kësaj ligji të zbehet. Komisioni dhe parlamenti gjithsesi janë për një trajtim të shpejtë të temës: Ato duan që brenda kësaj periudhe legjislative, pra përpara zgjedhjeve të BE-së vitin e ardhshëm, të bëjnë gati direktivat e BE-së, që pastaj duhet të zbatohen në legjislacionet kombëtare.

Se sa efekt mund të kenë norma të tilla europiane? Ato krijohen dhe zhbëhen sipas vullnetit të mirë të vendeve anëtare. Mbrojtësit e mjedisit i shohin këto masa të propozuara si një hap të parë drejt një rruge të gjatë. Sidoqoftë, qëkurse më 2016 është vendosur kufizimi i qeseve plastike, në BE ndërkohë është përgjysmuar konsumi i plastikës.

## HOROSKOPI

### DASHI

Beqarët mund të kenë disa mundësi për aventura romantike. Buxheti do e menaxhoni më me kujdes falë ndikimit pozitiv të planetëve. Do të bëni gjithçka për ta përmirësuar marrëdhënien në çift.

### DEMI

Me paratë nuk i keni pasur punët mirë. Edhe sot situata do të mbetet e njëjtë. Në dashuri sot do të bëni të pamundurën që ta forconi edhe më tepër raportin me partnerin. Mund të përballeni me disa zhgënjime në punë.

### BINJAKET

Personat të cilët nuk janë në një lidhje mund të hedhin hapa të pamenduar mirë dhe pa reflektuar gjatë. Nëse nuk tregoheni i kujdesshëm, mund të keni pasojë. Buxheti do stabilizohet vetëm falë ndihmës së të afërmeve.

### GAFORJA

Mund të merrni disa lajme të mira në punë. Nëse jeni duke menduar që të hapni një biznes, shanset janë që gjërat të shkojnë mirë. Parashikohet ditë me fat edhe për personat që nuk janë në një lidhje.

### LUANI

Kohët e fundit ndjeheni i vetmuar dhe me dëshirë për të pasur njerëz përreth vetes. Fati do të jetë në anën tuaj, madje edhe në krimin e raporteve të reja dashurore. Situata financiare parashikohet të jetë pozitive sot.

### VIRGJERESHA

Në aspektin financiar duhet sa më parë të filloni me disa specialistë që t'iu ndihmojnë të zgjidhni problemet. Do ndiheni për mrekulli në krahët e partnerit dhe buzëqeshja.

### PESHORJA

Sot mund të merrni disa propozime për punë. Vlerësoji me kujdes dhe pa shumë emocione. Vetëm kështu do të arrini që të merrni vendimin e duhur. Paratë nuk do ju mungojnë sot.

### AKREPI

Yjet ju favorizojnë në krijimin e një raporti të ri dashuror. Këshillohuni që t'i hidhni hapat në mënyrë graduale dhe pa u nxituar. Ne aspektin ekonomik, gjërat mund të marrin drejtimin e duhur.

### SHIGJETARI

Shmangni lojërat e fatit, sepse nuk do të jeni i favorizuar. Në raportin tuaj në çift mund të keni disa debate të forta për shkak të një personi të tretë. Financat nuk do jenë të shkëlqyera, por me mirë mbajeni gjendjen nën kontroll.

### BRICJAPI

Mund të ndjeni filladën e dashurisë. Është një emocion për të cilin keni nevojë. Buxheti do të përmirësohet goxha, falë një pagese të mirë që do merrni nga puna. Do gëzoheni pa masë për këtë gjë.

### UJORI

Do të keni fat për të përmirësuar situatën financiare, ndërsa në dashuri jo gjithçka po ecën mirë. Mos ndërmerrni veprime të gabuara në punë, pasi disa persona po përpiqen t'ju shkaktojnë probleme.

### PESHQIT

Nëse jeni duke menduar që të investoni në një projekt, shanset janë që gjërat të mos shkojnë si duhet. Aspekti planetar nuk është shumë favorizues, por kjo nuk do të thotë që të hiqni dorë.

**PRESIDENTI I SKËNDERBEUT**

**Takaj ul euforinë: Ishte vetëm një fitore, kampionati është i gjatë**

Presidenti i Skënderbeut, Ardjan Takaj, foli për mediat pas fitores me Partizanin në kryeqytet, ku u shpreh se pavarësisht suksesit, asgjë nuk ka mbaruar pasi skuadrat kanë rivalitet dhe diferenca mes Skënderbeut kryesues dhe Partizanit është vetëm 1 pikë. "Ishte një ndeshje e luftuar. Të

dy luamim për fitore, fituam ne, dhe kjo ishte e rëndësishme. Loja më pëlqeu, se ishte e luftuar. Ne po luajmë me çunat të rinj futboll, nuk është se qëllimi kryesor është titulli kampion. Janë edhe këto elementet e reja, që janë me perspektivë të madhe dhe të rëndësishëm për

klubin. Kampionati është i gjatë, këta janë çunat të rinj dhe duhet të qëndrojmë me këmbë në tokë, mos të kalojmë në eufori. Titulli do edhe eksperiencën për t'u fituar, edhe të rinjtë duhet të ambientohen. Fazën e tretë, do mësohet se kush është për kampion".

**DREJTORI I TË KUQVE**

**Olsi Rama: Skënderbeu e meritoi, prisja më shumë nga Partizani**

Drejtori i ekipit të Partizanit, Olsi Rama, foli për mediat pas humbjes me Skënderbeun brenda në kryeqytet nga ku deklaroi se pavarësisht rezultatit, asgjë nuk ka mbaruar, ndonëse pranon se kishte pritur diçka më shumë nga Partizani në këtë përballje. "Te Partizani vazhdojnë

ecin mirë gjërat. Kjo humbje nuk më shqetëson, pasi kampionati është ende i gjatë. Prisja një lojë më të mirë nga ekipi, luajtëm u përpoqëm. Skënderbeu ishte i vendosur shumë mirë në fushë, dhe e meritoi fitoren. Është projekti i Partizanit, nuk është projekti im. Dhe

nuk ishte vetëm për këtë ndeshje me Skënderbeun, është për këtë sezon, për kampionatin tjetër edhe më tej. Trashit? Unë shpresoj që ky vendim të ndikojë për mirë në të ardhmen. Sa i takon titullit, asgjë nuk ka përfunduar. Jemi në vendim e dytë, apo jo?"

Në "Selman Stërmasi" mbyllet 2-0 për korçarët që shënuan me Muzakën dhe Bregun në pjesën e dytë



Jeton Selimi

# Skënderbeu, leksion kampionësh Partizanit!

## Bardhekuqtë marrin kryesimin me 23 pikë

Skënderbeu mposht Partizanin për të dytën herë në 10 ndeshje, merr tre pikë dhe komandën e kampionatit, duke u rikthyer dhe njëherë aty ku e mbylli sezonin e shkuar, në krye të tabelës. Golat e Gjergj Muzakës dhe Dejvi Bregut u kanë dhënë kampionëve në fuqi triumfin 2-0 përballë rivalit direkt për titull, duke kthyer me këmbë në tokë të kuqtë e Gegës, që mbase fluturuan më lart se ç'duhet pas 5 fitoreve radhazi, ndërsa të shumtë kanë qenë ata që menduan se lënia e Trashit jashtë ishte një gabim dhe se ndikoi në rezultat. Në "Selman Stërmasi" loja nis me spektaklin e tifozërisë vendëse në tribuna, ndërsa në fushë 90 minutat janë me dy fytyra, në pjesën e parë dominojnë të kuqtë që i afrohen golit në minutën e 18-të, kur Asani nuk i jep këndin e duhur topit nga një pozicion i mirë, ndërsa pak çaste më pas (27) Belica nuk është i vëmendshëm në topin që i shpëton nga duart Orges Shehit.

**NDESHJA**  
Selman Stërmasi" loja nis me spektaklin e tifozërisë vendëse në tribuna, ndërsa në fushë 90 minutat janë me dy fytyra, në pjesën e parë dominojnë të kuqtë që i afrohen golit në minutën e 18-të, kur Asani nuk i jep këndin e duhur topit nga një pozicion i mirë, ndërsa pak çaste më pas (27) Belica nuk është i vëmendshëm në topin që i shpëton nga duart Orges Shehit.



SUPERLIGA	
JAVA E 10-të	
<b>TË SHITUNEN</b>	
Kamza - Tirana	1-1
Flamurtari - Teuta	1-1
<b>TË DIELEN</b>	
Kastrioti - Luftëtari	0-2
Laçi - Kukësi	0-1
<b>TË HENEN</b>	
Partizani - Skënderbeu	0-2
<b>RENDITJA</b>	
Skuadra	P
Skënderbeu	10 23
Partizani	10 22
Kukësi	10 19
Laçi	10 16
Teuta	10 15
Flamurtari	10 15
Tirana	10 9
Luftëtari	10 9
Kamza	10 8
Kastrioti	10 4

kuadratin nga jashtë zone. Pjesa e parë do të mbyllet me rrjetat të paprekura, ndërsa edhe në të dytën janë vendësit që e nisnin aty ku e lanë, por Skënderbeu do ta gjejë kthesën menjëherë me zëvendësimet e Orges Shehit që godet në

shenjë. Në fushë futet Muzaka, që sakrifikon pasi është i dëmtuar, ndërsa 6 minuta më vonë do të shënojë një gol të shkëlqyer. Radas harkon nga e majta në zonë, Kalari humbet Muzakën që gjuan fluturimthi dhe shënon në

bashkëpunim edhe me gardianin Alban Hoxha, që rikuperoi në momentet e fundit për të qenë i pranishëm në sfidë. 1-0 për kampionët, Skënderbeu në festë, Partizani tronditet, tronditje që nuk do ta kalojë dot pas veprimit të

bukur të Malës në pjesën e dytë. Minutat ecin dhe atëherë kur Enea Jorgji bëhet gati të vërshtëllëjë fundin e takimit, është Ardit Hoxhaj që harkon në zonë për Bregun, i cili gjuan në volej dhe mposht Hoxhën, me gardianin e

kuq që edhe njëherë thyhet në shtyllën e tij. 2-0, një fitore e merituar e Skënderbeut ndaj rivalit të tij kryesor, 3 pikë që e ngjisin në komandë me 23 pikë, 1 më shumë sesa kryeqytetasit, që mbeten të dytë me 22 pikë.

**TRAJNERI I SKËNDERBEUT**

Orges Shehi shijon suktesin. Një fitore e cila padyshim i takon edhe atij për mënyrën sesi e zgjidhi ndeshjen, duke aktivizuar në kohën e duhur Muzakën, goli i të cilit zhbllokoi takimin duke i dhuruar një fitore të madhe Skënderbeut. Për trajnerin durrak, skuadra e tij luajti më mirë në pjesën e dytë, ndërsa thekson se pavarësisht kënaqësisë së fitores ndaj një rivali direkt, ka ende shumë punë për të bërë.

**Ndeshje e luftuar nga të rinjtë, por e fituan ata me eksperiencë. E kishit menduar të tillë?**

Për Muzakën ishte dilema më e madhe, pasi kishte një kontraktim. Nuk doja ta rrezikoj, doja ta kisha si alternativë. Ishte asl ymë në mënyrë, edhe pse jo në formën më të mirë.

**Çfarë impulsit i jep skuadrës kjo fitore?**

Pavarësisht kreut, kjo fitore i jep skuadrës besim, ego për të vazhduar para. Duhet të



jemi me këmbë në tokë, dhe të mos mendojmë se kemi arritur gjithçka, sepse kur mendon kështu, do futeshim në dhe.

**Shehi: Më kënaq fitorja, por kemi shumë punë**

**Strategji ajo me Muzakën?**

Jo, unë nuk doja ta rrezikoj, sepse është i rëndësishëm. Mund të mungonte edhe më shumë nëse dëmtohet. Është stërvitur vetëm 2 ditë, por ishte zgjedhja ime që ta fusja si zëvendësim. E dimë zgjuarsinë që ka, merr topin dhe e tërheq ekipin.

**Po Gueuxh?**

Ai ka ardhur më vonë nga të gjithë, gjenden fizike nuk e ka të mirë. Kam kërkuar mesfushorë, dhe pozicioni ku ai luan, si dhe Demte e Muzaka, nuk kemi shumë alternativa.

**Shumë dyluftime të fituar nga Partizani...**

Jo vetëm dyluftime, me çfarë pashë unë dhe stafi, Partizani ka lojtarë cilësorë. Irrez-


ikshëm është topi i dytë, e kishim punuar gjatë javës të mos rrezikojmë në ato zona. Problemi jonë në pjesën e parë është se nuk po mbanim topin. Loja jonë kërkon që ta kemi në kontroll, dhe jo me top të gjatë.

**Jeni i kënaqur me këtë fitore, apo ekipi nuk funksionoi në diçka?**

Sigurisht që fitorja të kënaq, sepse fiton ndaj një rivali direkt, në atë pozicion ku jemi. E kotë ta mohojmë që nuk na kënaq, por ka shumë vend për përmirësim, që të ecim akoma më gjatë.



### Fjalëkryqi (1)



**HORIZONTAL**

- Mund të jetë kursimi.
- Ylli i Nostradamus.
- Tamam pa kufij.
- Ross këngëtare.
- 1 lashtë.
- Eshtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- Kufijtë e lëvizjes
- 1 ka tek plepi.
- Paguhet për shërbim.
- Fillojnë lejen.
- Kufizojnë trotuarat.
- Bëjnë karrierë në parti.
- Thahet me bonifikim.
- Mund të jetë unik një i tillë.
- Preka komik shkordran.
- Fund dhjetori.
- Fillojnë aksionin.
- Ente Operative Tiranë
- Agjenci Ajrore Durrës.
- Një pjesë e dimensioneve.

- Eshtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.
- Kalimi në ekstreme.
- Eshtë e re pas Krishtit.
- Shkruhet për të mos vazhduar më.
- Si i gjithë .
- Kush e thotë lutet.
- Kufij elementi.
- Ishte nyja që preu Aleksandri i Madh.
- Një pjesë e titanëve.
- Mund të jetë kundërmuese.
- Pak titanike.

**VERTIKAL**

- Si i përshtatëshëm.
- Mund të jenë fetare.
- Ai i kuq e ka një huq.
- Pak analogji.
- Eshtë metri i roboqepësit.
- Në hyrje të oazit.
- Arte pa re.
- Arthur që qe dramaturg.
- Janë boshte.
- Michelangelo regjisor.
- Mund të bëjë stil të lirë .
- Ishin monedhe të Tobias.
- Eshtë bas me katër tela.
- Pak efikasitet.
- Eshtë marrëveshje me nota.
- Ishte babai i Aklilit.
- Fillojnë nazet.
- Në krye të kuadrove.
- Eshtë faqe muri.
- Një apendix i menjëhershëm.
- Kurosawa që qe regjisor.
- Vriten nga espada.
- Eshtë shtet aziatik.
- Edouard piktor.
- Një transporti është kamioni.
- Unë i Freud.
- Një çigan.
- Fundi i një samurai.

### Fjalëkryqi (2)


**HORIZONTAL**

- Fillojnë panikun.
- Gibson aktor.
- Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- Mund të jetë trofe.
- Janë vendet si Katari
- Maureen që qe aktore.
- Janë kundërmuese.
- Mund të fitojnë etapa.
- Ushtojnë nga "ola".
- Një thirrje
- Janë ministritë.
- Një rrugë në Paris.
- Markë cigareje.
- Eshtë ngjinja.
- Ricciarelli soprano.
- Fillojnë sefte.
- Ente Ekonomike Sarandë.


- Mbyllin një ditar.
- Satelit i Jupiterit
- 1 ka tek Luani.
- Boldi komik italian.
- Eshtë kolana në filmat
- Kush e thotë lutet.
- Oxa këngëtare.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Eshtë tokë që... fitohet.
- Një... gjermane.

**VERTIKAL**


- Një votë në favor.
- Filozofi me eksperimentin e gomarit.
- Në hyrje makinës.
- Fillojnë lehtë.
- Irlanda në Dublin.
- Eshtë edhe ajo e historisë.
- Një pjesë e gamiljeve
- Notat pa kufij.
- Ishin komitë.
- Ka kryeqytet Islamabad.
- Don... i Interpretuar nga Terence
- Mbyllin aktet.
- Janë përmasa.
- Gjysma e lujjes.
- Castellito aktor.
- Inicilat e Dalí, piktor.
- Tanita këngëtare.
- Eshtë tryzni
- Në hyrje të Europës.
- Janë rrobat për t'u larë.
- Bën mëza.
- Moreau aktor.
- Janë thika.
- Një pjesë e satelitit.
- Janë teke në sende.
- Pak marramendëse.
- 1 ka tek zdapi.
- Inicialet e Nolte-s.



### Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

### SUDOKU

8			7			9	5	
6	5		4		2		8	3
7				8			4	
			2		4			
	8	5	6	1	7			
			8	5		2	1	
2					1	3	6	9
4		6						
7	9				5	4		

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	4	3	7	1	5	9	2	6
9	2	5	8	3	6	1	4	7
1	7	6	4	9	2	5	3	8
3	1	7	9	8	4	2	6	5
2	6	8	5	7	1	3	9	4
4	5	9	6	2	3	7	8	1
5	8	1	2	4	9	6	7	3
6	9	4	3	5	7	8	1	2
7	3	2	1	6	8	4	5	9

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9



### Argëtim filozofik

- Shpata nuk vret njeri; ajo është mjet në duart e vrasësit (Seneka)
- Jeta është shumë e shkurtër për të shpenzuar kohën duke lexuar një libër të keq (James Joyce)
- Dobësia e sjelljes bëhet dobësi e karakterit (Albert Einstein)
- Ata që nuk mund të ndryshojnë mendjen e vet nuk mund të ndryshojnë asgjë (George Bernard Shaw)

### KRIPTOSKEME

### KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

HORIZONTAL

1. MUND TË JETË KURSIMI  
2. YLLI I NOSTRADAMUS  
3. TAMAM PA KUFIJ  
4. ROSS KËNGËTARE  
5. 1 LASHTË  
6. ESHTË ALEANCA KU SAPOI KEMI ADERUAR  
7. KUFJTË E LËVIZJES  
8. 1 KA TEK PLEPI  
9. PAGUHET PËR SHËRMBIM  
10. FILLOJNË LEJEN  
11. KUFIZOJNË TROTUARAT  
12. BËJNË KARRIERË NË PARTI  
13. THAHET ME BONIFIKIM  
14. MUND TË JETË UNIK NJË I TILLË  
15. PREKA KOMIK SHKORDRAN  
16. FUND DHJETORI  
17. FILLOJNË AKSIONIN  
18. ENTE OPERATIVE TIRANË  
19. AGJENCI AJRORE DURRËS  
20. NJË PJESË E DIMENSIONEVE

VERTIKAL

1. SI I PËRSHTATËSHËM  
2. MUND TË JENË FETARE  
3. AI I KUQ E KA NJË HUQ  
4. PAK ANALOGJI  
5. ESHTË METRI I ROBAQEPËSIT  
6. NË HYRJE TË OAZIT  
7. ARTE PA RE  
8. ARTHUR QË QE DRAMATURG  
9. JANË BOSHTË  
10. MICHELANGELO REGJISOR  
11. MUND TË BËJË STIL TË LIRË  
12. ISHIN MONEDHE TË TOBIAS  
13. ESHTË BAS ME KATËR TELA  
14. PAK EFIKASITET  
15. ESHTË MARRËVESHJE ME NOTA  
16. ISHTE BABAI I AKLILIT  
17. FILLOJNË NAZET  
18. NË KRYE TË KUADROVE  
19. ESHTË FAQE MURI  
20. NJË APENDIX I MENJËHERSHËM  
21. KUROSAWA QË QE REGJISOR  
22. VRITEN NGA ESPADA  
23. ESHTË SHTET AZIATIK  
24. EDOUARD PIKTOR  
25. NJË TRANSPORTI ËSHTË KAMIONI  
26. UNË I FREUD  
27. NJË ÇIGAN  
28. FUNDI I NJË SAMURAI

**FJALËKRYQI (2)**

HORIZONTAL

1. FILLOJNË PANIKUN  
2. GIBSON AKTOR  
3. NË MES TË COGITO DHE SUM E THËN NGA DESCARTES  
4. MUND TË JETË TROFE  
5. JANË VENDET SI KATARI  
6. MAUREEN QË QE AKTORE  
7. JANË KUNDËRMUESE  
8. MUND TË FITOJNË ETAPA  
9. USHTOJNË NGA "OLA"  
10. NJË THIRRJE  
11. JANË MINISTRITË  
12. NJË RRUGË NË PARIS  
13. MARKË CIGAREJE  
14. ESHTË NGJINJA  
15. RICCIARELLI SOPRANO  
16. FILLOJNË SEFTE  
17. ENTE EKONOMIKE SARANDË

VERTIKAL

1. MBYLLIN NJË DITAR  
2. SATELIT I JUPITERIT  
3. 1 KA TEK LUANI  
4. BOLDI KOMIK ITALIAN  
5. ESHTË KOLANA NË FILMAT  
6. KUSH E THOTË LUTET  
7. OXA KËNGËTARE  
8. INICIALET E NOLTE AKTOR  
9. ESHTË TOKË QË... FITOHET  
10. NJË... GJERMANE  
11. NJË VOTË NË FAVOR  
12. FILOZOFI ME EKSPERIMENTIN E GOMARIT  
13. NË HYRJE MAKINËS  
14. FILLOJNË LEHTË  
15. IRLANDA NË DUBLIN  
16. ESHTË EDHE AJO E HISTORISË  
17. NJË PJESË E GAMILJEVE  
18. NOTAT PA KUFIJ  
19. ISHIN KOMITË  
20. KA KRYEQYTET ISLAMABAD  
21. DON... I INTERPRETUAR NGA TERENCE  
22. MBYLLIN AKTET  
23. JANË PËRMASA  
24. GJYSMA E LUJJES  
25. CASTELLITO AKTOR  
26. INICILAT E DALÍ, PIKTOR  
27. TANITA KËNGËTARE  
28. ESHTË TRYZNI  
29. NË HYRJE TË EUROPËS  
30. JANË RROBAT PËR T'U LARË  
31. BËN MËZA  
32. MOREAU AKTOR  
33. JANË THIKA  
34. NJË PJESË E SATELITIT  
35. JANË TEKE NË SENDE  
36. PAK MARRAMENDËSE  
37. 1 KA TEK ZDAPI  
38. INICIALET E NOLTE-S

### Thënie të mençura

- Nëse nuk ka Zot, çdo gjë është e lejuar (Fyodor Dostoyevsky)
- Sarkazma është streha e fundit e njeriut modest dhe të moralshëm kur privatësia e shpirtit të tij shkelet dhunshëm
- Një betejë është e humbur kur mendon se e ke humbur (Jean-Paul Sartre)
- Jeta është përgatitje e gjatë për diçka që nuk ndodh (W. B. Yeats)

